

PLANI I VEPRIMIT PËR KONTROLLIN E ZHURMAVE NË BASHKINË TIRANË 2022 - 2027

Hartoi:

“ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” sh.p.k

Ekipi

*Klodian ALI, Etleva Bodinaku, Ermira (Kocu)Decka, Seni Mema,
Altin Xhafaj, Ark Rilinda Shehu ,ing.Florian Shehu*

@ e drejta e autorit

Asnjë pjesë e këtij dokumenti të shtypur nuk mund të riprodhohet, publikohet, fotokopjohet, filmohet apo kopjohet me ndonjë mënyrë tjetër pa marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga EMC Studio. Po ashtu ky dokument nuk mund të përdoret pa miratim për asnjë qëllim tjetër përveç atij për të cilin është hartuar. EMC Studio nuk mban asnjë përgjegjësi për përdorimin e këtijdokumenti nga persona të tjerë përveç atyre për të cilët është përgatitur dokumenti.

PËRMBAJTJA	2
Hyrje	5
1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT	6
Qëllimi i hartimit të PLVZHBT.....	6
Objektivat e PLVZHBT	6
Përqasja teknike dhe Metodologjia	6
2. KUADRILIGJOR KOMBËTAR DHENDËRKOMBËTAR, POLITKAT DHE STANDARDET E ZBATUESHME PËR MENAXHIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS.....	8
Analiza e kuadrit ligjor ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor lidhur me menaxhimin e zhurmave në mjedis	8
Kuadri ligjor ndërkombëtar për zhurmat	8
Kuadri ligjor kombëtar dhe vendor	10
Planet dhe programet rajonale, kombëtare dhe vendore të zhvillimit urban, infrastrukturës etj. zbatimi i të cilave kërkon menaxhimin e zhurmës në mjedis.....	18
Politikat e Bashkimit Evropian dhe ato Kombëtare lidhur me zhurmat dhe nevoja e përshtatjes së planeve të veprimit në përmbushje të këtyre politikave.....	20
3. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SITUATËS NË BASHKINË TIRANË NË LIDHJE ME MENAXHIMIN E ZHURMËS.....	25
4. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I BURIMEVE QË GJENEROJNË ZHURMË DHE SHKAKTOJNË NDOTJE AKUSTIKE.....	29
Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor.....	29
Identifikimi i aktiviteteve dhe përqendrimit të tyre në territorin e Bashkisë.....	29
Vlerësim i popullsisë së ndikuar prej tyre.....	31
Vlerësimi i kushteve specifike të liçencimit dhe kontrolli i zbatimit të kërkesave ligjore në lidhje me menaxhimin e zhurmës në mjedis.....	31
Sektori i transportit	31
Identifikimi i mjeteve dhe aktiviteteve të transportit, si dhe numrit të mjeteve që qarkullojnë në territorin e Bashkisë Tiranë	32
Identifikimi i orëve të pikut dhe zonave problematike.....	33
Vlerësimi popullatës së ndikuar nga zhurmat e gjeneruara nga sektori i transportit.....	33
Vlerësimi i sinjalistikës ekzistuese dhe elementeve të integruara në të në lidhje me ndalimin dhe reduktimin e zhurmës në mjedis	35
Identifikimi dhe vlerësimi i objekteve të rëndësisë dhe karakterit të veçantë si institucione, shkolla, spitale etj. të ekspozuara ndaj zhurmës së krijuar nga sektori i transportit.....	37

Pajisjet dhe makineritë që gjenerojnë zhurmë	38
Identifikimi i pajisjeve dhe makinerive që gjenerojnë zhurmë dhe si ndikojnë ato në popullatë.....	38
Identifikimi i grupeve të popullsisë dhe institucioneve të veçanta të ekspozuar ndaj tyre	39
Vlerësimi i kushteve specifike të liçencimit dhe kontrolli i zbatimit të kërkesave ligjore në lidhje me menaxhimin e zhurmës në mjedis. Mundësia e eliminimit dhe / ose shmangies.....	39
5. VLERËSIMI SHKALLËSË NDIKIMIT TË SECILIT BURIM NË NDOTJEN AKUSTIKE	40
Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor.....	40
Sektori i transportit	40
Pajisjet dhe makineritë që gjenerojnë zhurmë	40
6. MASAT E PROPOZUARA PËR REDUKTIMIN APO ELIMINIMIN E ZHURMAVE NË MJEDIS DHE ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË PLANIT	40
7. PËRLLOGARITJA E KOSTOVE DHE PLANIFIKIMI I FONDEVE TË NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E PLVZHBT	46
Shtojca 1	51
Shtojca 2	52

Lista e grafikëve

<i>Grafiku 1: Vlerat e Laeq-Ditë, për secilin nga Stacionet e monitorimit në vitet 2007-2020</i>	<i>27</i>
<i>Grafiku 2: Vlerat e Laeq-Natë, për secilin nga Stacionet e monitorimit në vitet 2007-2020</i>	<i>27</i>
<i>Grafiku 3: Njësitë administrative më të ekspozuara ndaj zhurmës në qytetin e Tiranës</i>	<i>35</i>

Lista e tabelave

<i>Tabela 1: Vlerat udhëzuese për zhurmën e komunitetit sipas legjislacionit shqiptar.....</i>	<i>13</i>
<i>Tabela 2: Niveli mesatar i zhurmave gjatë ditës (6.00 - 23.00), LAeq (dB).....</i>	<i>25</i>
<i>Tabela 3: Niveli mesatar i zhurmave gjatë natës (23.00 - 6.00), LAeq (dB).....</i>	<i>26</i>
<i>Tabela 4: Itineraret e transportit dhe oraret përkatëse</i>	<i>31</i>
<i>Tabela 5: Njësitë dhe popullsia më e ekspozuar ndaj zhurmës së transportit</i>	<i>33</i>
<i>Tabela 6: Akset rrugore të vrojtura gjatë hartimit të planit.....</i>	<i>34</i>
<i>Tabela 7: Nivelet mesatare të zhurmës së gjeneruar nga makineritë që operojnë në mjedis të hapur.....</i>	<i>38</i>
<i>Tabela 8: Njësitë dhe popullsia më e ekspozuar ndaj zhurmës së pajisjeve dhe makinerive.</i>	<i>39</i>
<i>Tabela 9: Njësitë administrative prioritare për masat e kontrollit ndaj zhurmës.....</i>	<i>41</i>
<i>Tabela 10: Matrica e masave për kontrollin dhe menaxhimin e zhurmës në territorin e Bashkisë Tiranë.....</i>	<i>42</i>

Lista e figurave

<i>Figura 1: Poli i zhvillimit rajonal Tiranë – Durrës.....</i>	<i>18</i>
<i>Figura 2: Ilustrim i ndikimit nga zhurma mjedisore në Evropë.....</i>	<i>21</i>
<i>Figura 3: Harta e stacioneve të monitorimit të zhurmës në qytetin e Tiranës.....</i>	<i>28</i>
<i>Figura 4: Hartë e niveleve të monitoruara të zhurmës në qytetin e Tiranës.....</i>	<i>28</i>
<i>Figura 5: Burime të zhurmës në mjedis (Burimi: Montgomery County website).....</i>	<i>29</i>
<i>Figura 6: Gomisteri (majtas) dhe servis motorçikletash (djathtas) në blloqet e banimit pranë rrugës Mine Peza.....</i>	<i>30</i>
<i>Figura 7: Bar kafe në objekt banimi me aktivitet të lartë zhurmash deri në orët e vona të mbrëmjes.....</i>	<i>30</i>
<i>Figura 8: Njësitë dhe popullsia më e ekspozuar ndaj zhurmës së objekteve të shërbimeve sociale dhe kulturore.....</i>	<i>32</i>
<i>Figura 9: Qarkullimi intensiv i mjeteve në rrugën Mine Peza (shumë banesa përgjatë rrugës pa izolim akustik).....</i>	<i>32</i>
<i>Figura 10: Njësitë administrative më të ekspozuara ndaj zhurmës në Bashkinë Tiranë.....</i>	<i>35</i>
<i>Figura 11: Nivelet e zhurmës së gjeneruar nga tipe të ndryshme automjetesh në varësi të nivelit të shpejtësisë.....</i>	<i>36</i>
<i>Figura 12: Gjeneratori dhe aspiratori i një subjekti shërbimi.....</i>	<i>38</i>

Hyrje

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të popullatës, Bashkia Tiranë ka inicuar hartimin e Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat (PLVZH) në territorin e saj.

“Zhurmë mjedisore” është çdo tingull i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore, përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale, etj. Gjenerimi i zhurmave ka efekte negative në shëndetin e njeriut, si dhe në mjedis dhe për këtë duhen marrë masa mbrojtëse për zvogëlimin e nivelit të zhurmave në mjedis nëpërmjet ndërhyrjeve dhe veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

Referuar Organizatës Botërore të Shëndetit pasojat më të rëndësishme të zhurmës në përgjithësi janë: humbja e dëgjimit, çrregullimet e gjumit, efektet fiziologjike, stresi i lidhur me punën dhe rritja e rrezikut të aksidenteve. Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës.

Burimet kryesore të zhurmave mjedisore janë:

- Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor (klube nate, bare, restorante, disko, reparte shërbimesh të ndryshme etj.);
- Sektori i transportit (rrugor, ajror, ujqor dhe hekurudhor) dhe zhurmat që gjeneron ky sektor;
- Aktivitetet ekonomike që përdorin pajisje dhe makineritë që gjenerojnë zhurma si: sharra, elektromotorë, gjeneratorë, çekiçë pneumatikë, etj.

Duke qenë se nivelet e tejkaluara të zhurmës përbëjnë shqetësim të vazhdueshëm për komunitetin dhe banorët e ekspozuar ndaj saj me pasoja direkte në shëndet, duke marrë parasysh numrin e popullsisë që banon në qytet, numrin e automjeteve që qarkullojnë, bizneseve që operojnë, etj., hartimi i Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat për Bashkinë Tiranë është i domosdoshëm. Nevoja për hartimin dhe zbatimin e masave për kontrollin e zhurmës është identifikuar edhe në Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.

Hartimi i PLVZH është kërkesë e Ligjit nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i cili e sanksionon këtë në Nenin 20, pika 4, si një detyrë që pason hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për menaxhimin mjedisor të zhurmave. Ky ligj është në linjë me Direktivën 2002/49/EC të Zhurmës Mjedisore, e cila detyron shtetet anëtare të BE të hartojnë fillimisht planet kombëtare të veprimit për menaxhimin mjedisor të zhurmave dhe menjëherë pas kësaj, direktiva parashikon dhe përcakton afate për hartimin e planeve lokale të zhurmave. Ndonëse Shqipëria nuk është ende shtet anëtar, në kuadër të procesit të stabilizim - asociimit të nisur prej vitesh, ajo ka përafëruar në pjesën më të madhe legjisllacionin e saj me atë të BE, nga i cili nuk bën përjashtim ligji aktual i zhurmave.

Hartimi i PLVZH i Bashkisë Tiranë konsiston në një punë komplekse nga ekipi i konsulentëve që kombinon proceset e kryera në zyrë me ato në terren. Puna në terren për realizimin e vlerësimit faktik të burimeve që gjenerojnë zhurmë dhe ndotje akustike, si dhe vlerësimin e shkallës dhe kontributit të secilit aktivitet që gjeneron zhurmë dhe ndotje akustike është thelbësore për hartimin e masave të zbatueshme dhe që sjellin pasojat e pritshme dhe të synuara në reduktimin dhe eliminimin e zhurmës në territorin e Bashkisë Tiranë.

Draft PLVZHBT u konsultua me grupet e interesit të cilat dhanë komente dhe sugjerime për përmirësimin dhe zbatimin e PLVZHBT.

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT

Qëllimi i hartimit të PLVZHBT

Plani Lokal i Veprimit mbi Zhurmat pati si qëllim analizimin e situatës në të cilën gjendet Bashkia Tiranë lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit për mbrojtjen nga zhurmat, vlerësimin e shqetësimeve të komunitetit dhe të bizneseve lidhur me zhurmat. Nëpërmjet kësaj analize, Plani synon të identifikojë boshllëqet ekzistuese ligjore dhe organizative në drejtim të administrimit të zhurmës dhe, bazuar në përvojat më të mira përkatëse, të propozojë masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për zbatimin e kërkesave të ligjit për mbrojtjen nga zhurmat.

Ky plan veprimi analizon dhe parashikon masa ligjore, administrative dhe organizative të domosdoshme për t'u ndërmarrë në përbushje të kërkesave të ligjit për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis, me synimin e administrimit të qëndrueshëm dhe reduktimit të nivelit të zhurmave në mjedis. Në këtë kontekst, objektivi kryesor i Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Objektivat e PLVZHBT

Ndër objektivat kryesore të Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat përfshihen:

- Fuqizimi institucional i Bashkisë Tiranë për menaxhimin e zhurmave.
- Përmirësimi i infrastrukturës për reduktimin e zhurmave.
- Forcimi i ligjit dhe masave për kontrollin e zhurmës.
- Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i operatorëve që gjenerojnë zhurma për pasojat e saj në mjedis dhe shëndet dhe masat që duhet të zbatohen për kontrollin dhe menaxhimin e saj.

Përqasja teknike dhe Metodologjia

Përqasja teknike dhe metodologjia e hartimit të PLVZHBT u bazua së pari në qëllimin, objektivat dhe rezultatet e pritshme nga Bashkia Tiranë të përcaktuara në Shtojcën 15 të DST. Bazuar në këto terma dhe pritshmëri, ekipi i Konsulentit zhvilloi një metodologji standarde për hartimin e planeve të veprimit, e cila ndjek një cikël fazash të njëpasnjëshme, ku përfundimi i fazës pararendëse është kusht dhe domosdoshmëri për zbatimin e aktiviteteve në fazën pasardhëse. Bazuar në këtë qasje logjike janë përcaktuar 4 faza, secila me aktivitete dhe rezultate e produktet e pritshme. Duhet theksuar se Konsulenti vlerëson të rëndësishëm përdorimin e të dhënave dhe informacionit të saktë e të verifikueshëm; kjo rrjedhimisht do të rezultojë në një Plan cilësor, i cili reflekton saktësisht situatën e zhurmave mjedisore në Bashkinë Tiranë, si dhe përcakton masa të zbatueshme që sjellin pasojat e rezultatet e synuara për reduktimin e zhurmës në territorin e Bashkisë. Kjo metodikë është e zbatueshme në gjithë territorin e Bashkisë Tiranë pavarësisht karakterit urban, industrial apo rural të zonave të veçanta.

Ndonëse Plani bazohet në kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, ku ky i fundit është konsideruar më së shumti në kontekstin e përqasjeve teknike, hartimi i masave të PLVZH dhe vetë zbatimi i tyre i përmbahet kuadrin ligjor lokal dhe kompetencave e mundësive të Bashkisë Tiranë, duke bërë një dallim të qartë midis këtyre të fundit dhe atyre të synuara ndërkombëtare. Gjithashtu, për t'i mundësuar Bashkisë Tiranë forcimin e zbatimit të ligjit dhe masave që përcakton PLVZH, analiza ligjore në kuadër të planit evidenton edhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, aktivitetet e të cilëve gjenerojnë zhurmë e ndotje akustike. Kjo lehtëson punën e bashkisë për liçencimin e këtyre aktiviteteve dhe monitorimin e aktivitetit të tyre në faza të ndryshme.

Gjithashtu në hartimin e këtij Plani janë konsideruar planet dhe programet kombëtare, rajonale dhe vendore me qëllim bashkërendimin dhe integrimin e PLVZH në ta. Në këtë analizë përfshihen planet ekzistuese dhe të planifikuara e në procese hartimi e miratimi nga vetë Bashkia Tiranë me qëllim që PLVZHBT të kontribuojë në kontrollin e zhurmës në tërësi dhe bëhet dhe mjet i zbatimit të politikës kombëtare për menaxhimin e zhurmës mjedisore.

Një element shumë i rëndësishëm gjatë përcaktimit të masave është përlogaritja e kostove financiare të nevojshme për zbatimin e secilës masë, të cilat duhen vlerësuar duke marrë në konsideratë kapacitetet e Bashkisë Tiranë, e cila duhet të planifikojë në vijim edhe buxhetin përkatës. Plani përfshin edhe mekanizmin e vlerësimit të zbatimit të masave, i cili konsiston në një numër të caktuar indikatorësh të përshtatshëm për secilën masë të propozuar.

Duke qenë se nivelet e tejkaluara të zhurmës përbëjnë shqetësim të vazhdueshëm për komunitetin dhe banorët e ekspozuar ndaj saj, për të adresuar ankesat e mundshme të tyre ndaj këtij shqetësimi, Plani përfshin edhe hartimin e një mekanizmi të trajtimit të ankesave. Ky mekanizëm do të hartohet sipas një formati të caktuar që përfshin nga regjistrimi i ankesës e deri në zgjidhjen e saj.

Gjatë procesit të punës u konsultuan dhe përdoren udhëzime ndërkombëtare të praktikës së menaxhimit të zhurmës.

2. KUADRI LIGJOR KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR, POLITKAT DHE STANDARDET E ZBATUESHME PËR MENAXHIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS

Analiza e kuadrit ligjor ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor lidhur me menaxhimin e zhurmave në mjedis

Kuadri ligjor ndërkombëtar për zhurmat

Kuadri rregullator kombëtar për zhurmat, të cilit i referohet dhe Shqipëria është sistemi rregullator i Bashkimit Europian, Direktiva dhe Rregulloret dhe njëkohësisht dhe Organizata Botërore e Shëndetit. Gjithashtu, në përfaqshjen apo në hartimin e standardeve të reja, sidomos ato të konformitetit të pajisjeve Shqipëria referohet tërësisht kuadrit ndërkombëtar dhe kryesisht për konformitetin standard të pajisjeve dhe makinerive. Shumë makineri që emetojnë zhurmë kërkojnë shënimin CE para se të shiten në BE. Shenja CE tregon se një produkt është vlerësuar nga prodhuesi dhe konsiderohet se plotëson kërkesat e BE -së për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit. Kërkohet për produktet e prodhuara kudo në botë që më pas tregtohen në BE. Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve¹ është institucioni që udhëheq hartimin e standardeve të konformitetit në Shqipëri.

Nisur nga këto kërkesa dhe Shqipëria ka hartuar dhe zbaton një kuadër ligjor që ndërthur kërkesa e rregulla nga këto 2 institucione kryesore, Bashkimin Europian (Komisionin dhe Parlamentin e EU) dhe standarde që lidhen me mbrojtjen direkte të shëndetit nga efektet e zhurmës, këto të fundit referohen dhe bazohen në udhëzimet e OBSH. Në mënyrë më të detajuar sistemet ndërkombëtare referuese për standardet kombëtare të zhurmës pasqyrohen në vijim.

Bashkimi Evropian

Direktiva 2002/49/EC e Zhurmës Mjedisore

Direktiva 2002/49/EC² në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore (Direktiva e Zhurmës Mjedisore - DZHM) është instrumenti kryesor i BE-së për të identifikuar nivelet e ndotjes nga zhurma dhe për të shkaktuar veprimet e nevojshme, si në shtetet anëtare, ashtu edhe në nivel të BE-së. Për të ndjekur qëllimet e saj të deklaruara, Direktiva e Zhurmës Mjedisore fokusohet në tri fusha veprimi:

- përcaktimi i ekspozimit ndaj zhurmës së mjedisit;
- duke siguruar që informacioni mbi zhurmën mjedisore dhe efektet e tij të vihet në dispozicion të publikut;
- parandalimi dhe zvogëlimi i zhurmës mjedisore aty ku është e nevojshme dhe ruajtja e cilësisë së zhurmës mjedisore aty ku është e mirë.

Direktiva zbatohet për zhurmën ndaj së cilës njerëzit janë të ekspozuar, veçanërisht në zonat e ndërtuara, në parqet publike ose zona të tjera të qeta në një grupim, në zona të qeta në vende të hapura, pranë shkollave, spitaleve dhe ndërtesave dhe zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmës. Nuk zbatohet për zhurmën që shkaktohet nga vetë personi i ekspozuar, zhurma nga aktivitetet shtëpiake, zhurma e krijuar nga fqinjët, zhurma në vendet e punës ose zhurma brenda mjeteve të transportit ose për shkak të aktiviteteve ushtarake në zonat ushtarake.

Shumë nga kërkesat e kësaj Direktive janë transpozuar dhe në kuadrin ligjor shqiptar kryesisht në kuadrin ligjor të zhurmave hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe ajo e Shëndetësisë dhe Transporteve. Në raportin e Progresit të Shqipërisë 2020 Komisioni Europian³ vlerëson se “Shqipëria duhet të forcojë kapacitetin e saj administrativ për përgatitjen e hartave strategjike të zhurmës dhe planet e veprimit”.

¹ DPS është korrespondent në ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim), anëtar pa të drejtë vote në CEN (Komiteti Evropian i Standardeve)

² Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council of 25 June 2002 relating to the assessment and management of environmental noise

³ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

Në këtë kontekst ka nisur përgatitja e disa planeve vendore për menaxhimin e zhurmës përfshi dhe këtë plan veprimit të Bashkisë Tiranë.

Direktiva 2000/14/EC mbi emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura.

Komisioni Evropian e ka identifikuar zhurmën si një nga problemet më urgjente në zonat urbane në të gjithë Evropën dhe theksoi nevojën për të ndërmarrë veprime mbi burime të ndryshme të zhurmës, si pjesë e planit të tij të veprimit mjedisor në 1993. "Politika e mëvonshme e zhurmës" pasuese përcakton hapa për zhvillimin e një direktive për të rregulluar në mënyrë specifike zhurmën e krijuar nga pajisjet në natyrë. Pothuajse të gjitha 57 llojet e pajisjeve janë gjithashtu brenda fushës së Direktivës së Makinerisë 2006/42/EC dhe të dy direktivat trajtojnë çështjet që dalin nga emetimet e zhurmës. Sidoqoftë, direktiva e makinerisë fokusohet në sigurinë në punë të operatorit.

Direktiva u miratua më 8 maj 2000 dhe ka qenë e zbatueshme që nga 3 janari 2002. Dy objektivat kryesore të saj janë: a) sigurimi i një shkalle të lartë mbrojtjeje për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve dhe mjedisit dhe b) sigurimi i qarkullimit të lirë në tregun e brendshëm për produktet e mjetet industriale. Direktiva përcakton kërkesa specifike teknike për çlirimin e zhurmës dhe detyrimin e etiketimit për; pajisjet e pastrimit; pajisjet e ndërtimit; pajisjet e kopshtarisë; ngarkimi dhe ngritja e pajisjeve; gjeneratorë të energjisë dhe pajisje ftohëse; pajisjet e pompimit dhe thithjes; mjetet e dëborës dhe pastruesit e borës dhe grumbullimi, përpunimi dhe riciklimi i mbeturinave.

Shumë nga kërkesat e kësaj Direktive janë transpozuar dhe në kuadrin ligjor shqiptar nëpërmjet standardeve të konformitetit që hartohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve.

Organizata Botërore e Shëndetit

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) është një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara përgjegjëse për shëndetin publik ndërkombëtar e themeluar në vitin 1948. Shqipëria është anëtarësuar në OBSH prej 65 ndërsa zyra e OBSH në Shqipëri është hapur në vitin 1991.

Në Konferencën e Pestë Ministrore për Mjedisin dhe Shëndetin në Parma, Itali, në vitin 2010, OBSH-së i është kërkuar nga Shtetet Anëtare në Rajonin Evropian për të prodhuar udhëzime për zhurmën që nuk përfshinin vetëm burimet e zhurmës së transportit, por edhe pajisjet elektronike personale, lodrat dhe turbinat me erë, të cilat ende nuk ishin marrë parasysh në udhëzimet ekzistuese. Për më tepër, Direktiva e Bashkimit Evropian 2002/49/KE në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore (FUND) dhe teknike të lidhura me të, udhëzimet nga Agjencia Evropiane e Mjedisit, të dyja, përpunuan çështjen e zhurmës mjedisore dhe rëndësinë e udhëzimeve të përditësuara të zhurmës.

Zhurma është shfaqur si një shqetësim kryesor mjedisor në Rajonin Evropian të OBSH-së dhe ankesat e publikut për zhurmën e tepërt po rriten. Ministrat evropianë të shëndetësisë dhe mjedisit ripohuan në Deklaratën e Parmës 2010 thirrjen e tyre për të zvogëluar ekspozimin e fëmijëve ndaj zhurmës së dëmshme në mjedise të ndryshme. Një ekspozim i tillë mund të ketë pasoja gjatë gjithë jetës.

Udhëzimet e OBSH-së për Zhurmën në komunitet

Udhëzimet e OBSH-së për Zhurmën në Komunitet të vitit 1999 ishin udhëzimet e para të OBSH-së mbi temën e zhurmës dhe ishin një përgjigje praktike ndaj nevojës për veprim mbi zhurmën e komunitetit në nivel lokal, si dhe nevojës për përmirësimin e legjislacionit, menaxhimit dhe udhëzimit në nivelet kombëtare dhe rajonale.

Udhëzimet e OBSH-së për Zhurmën e natës në Evropë

Udhëzimet e OBSH-së për Zhurmën e natës në Evropë (2009) ofrojnë rekomandime që vendet mund t'i përdorin lehtësisht për të vendosur kufij të synuar për zhurmën e natës. Këto udhëzime mbështesin dhe integrojnë Direktivën e 2002 të Bashkimit Evropian për Zhurmën Mjedisore (2002/49/EC), e cila kërkon nga vendet që të hartojnë pikat e nxehta dhe të zvogëlojnë ekspozimin, por nuk përcakton vlera kufitare.

Udhëzimi për Zhurmën Mjedisore për Rajonin Evropian⁴ (2018)

Zhurma është një çështje e rëndësishme e shëndetit publik. Ajo ka ndikime negative në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe është një shqetësim në rritje. Zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën ka zhvilluar këto udhëzime, bazuar në kuptimin në rritje të këtyre ndikimeve shëndetësore të ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore. Qëllimi kryesor i këtyre udhëzimeve është të japë rekomandime për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga ekspozimi ndaj zhurmës mjedisore që buron nga burime të ndryshme: zhurma e transportit (trafikurrugor, hekurudha dhe avionë), zhurma e turbinës me erë dhe zhurma e kohës së lirë. Udhëzimet e OBSH-së mbështeten në dëshmi, të cilat janë thelbësore për të nxitur veprimet e politikave që do të mbrojnë komunitetet nga efektet e dëmshme të zhurmës.

Kuadri ligjor kombëtar dhe vendor

Në Shqipëri legjislacioni për zhurmat ka avancuar duke synuar të përafrohet vazhdimisht me Direktivat e Standardet e BE dhe Udhëzimet e OBSH-së. Ligji i parë që bazohet me parimet e BE u miratua në vitin 2007 dhe në zbatim të tij janë hartuar dhe miratuar disa akte nënligjore. Këto akte ligjore përcaktojnë detyra dhe rregulla për subjektet e ligjit ku përfshihen autoritetet qendrore, vendore dhe subjektet veprimtaria e të cilëve emeton zhurma në mjedis.

Ligji kryesor lidhur me zhurmat mjedisore është Ligji nr. 9774 datë, 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i cili ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Fusha e zbatimit të këtij ligji lidhet me zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen, në zona të banuara, në mjedise në institucione publike, në parqe publike dhe hapësira të tjera, të qeta, çlodhëse, në zona të qeta në natyrë, në institucionet për fëmijë, shëndetësore, arsimore, kulturore, të kultit dhe në mjedise të tjera të ngjashme me to.

Disa nga dispozitat rregullatore të ligjit nr. 9774 datë 12.07.2007:

Neni 8 - Organet e qeverisjes vendore

Organet e qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre:

- Drejtojnë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshillat e bashkive/komunave.
- Drejtojnë procesin e hartimit të zhurmës.
- Shpallin zona të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.
- Kërkojnë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës.
- U kërkojnë organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

⁴ Environmental Noise Guidelines for the European Region. World Health Organization 2018

Neni 9- Masat mbrojtëse

- Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.
- Masat e mbrojtjes nga zhurma përfshijnë:
- përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive, të pajisjeve prodhuese e teknologjive dhe mjeteve lëvizëse ose jolëvizëse, që lëshojnë zhurmë të niveleve të ulëta;
- përzgjedhjen e vendit, që instalimi dhe funksionimi i mjeteve e pajisjeve që lëshojnë zhurmë, të garantojnë nivelin kufi në të gjitha mjediset, të cilat ndikohen prej saj;
- masat parandaluese e zbutëse të zhurmës në pikën e lëshimit, përgjatë rrugëve të përhapjes dhe në mjediset që ndikohen prej saj.
- Masat konkrete ndërmerren në bazë të matjes, llogaritjeve dhe monitorimeve të nivelit të zhurmës.

Neni 10- Oraret

Llojet e masave mbrojtëse nga zhurma zbatohen në lidhje të ngushtë me oraret kur lëshohet zhurma. Për këtë qëllim, 24 orët ndahen në këto orare:

- Dita zgjat 13 orë, prej orës 06⁰⁰ deri në orën 19⁰⁰;
- Mbrëmja zgjat 4 orë, prej orës 19⁰⁰ deri në orën 23⁰⁰;
- Nata zgjat 7 orë, prej orës 23⁰⁰ deri në orën 06⁰⁰.

Neni 11- Kushtet për lëshuesit e zhurmës:

- Makineritë, mjetet e transportit, pajisjet e teknologjitë, para se të dalin në treg apo të vihen në përdorim, pajisen me dokumentacionin shoqëruar që tregon të dhënat për fuqinë e zhurmës që lëshojnë.
- Personat fizikë dhe juridikë, që zotërojnë e përdorin burimet e zhurmës, plotësojnë kushtet teknike, që garantojnë respektimin e niveleve të zhurmës, të përcaktuara në dokumentacionin shoqëruar.
- Për burimet ekzistuese të zhurmës, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, personat fizikë ose juridikë bëjnë ndërhyrjet e nevojshme për zbatimin e ligjit dhe të akteve përkatëse nënligjore.

Neni 13- Planifikimi i rregullimit të territorit:

- Organet e qeverisjes qendrore apo vendore, personat fizikë e juridikë, që hartojnë apo miratojnë planet e rregullimit të territorit, zbatojnë kërkesat për reduktimin e zhurmës në mjedis.
- Ministri, në bashkëpunim me ministrin që mbulon rregullimin e territorit, miraton udhëzimin për kërkesat dhe rregullat për reduktimin e zhurmave në mjedis që në procesin e hartimit të planeve të rregullimit të territorit.

Neni 14 - Projektimi i ndërtesave

- Çdo ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, për banim apo për veprimtari të tjera ekonomike e shoqërore, projektohet dhe realizohet në mënyrë që zhurma në brendësi apo në afërsi të saj, të jetë brenda nivelit kufi. Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të ndërtesës shoqërohet me masa mbrojtëse nga zhurma, për respektimin e vlerës kufi.
- Ministri, në bashkëpunim me ministrin që mbulon punët publike, miraton udhëzimin për rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma që në fazën e projektimit dhe gjatë ndërtimit të ndërtesave.

Neni 15 - Shfrytëzimi i ndërtesave

- Organi i qeverisjes vendore, që jep lejen e shfrytëzimit të objektit, me përjashtim të banesave vetjake, verifikon edhe zbatimin e kërkesave të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji.
- Ministri, në bashkëpunim me ministrin që mbulon punët publike, miraton udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave, para se ato të vihen në përdorim.

Neni 18 - Veprime të ndaluara

Në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të ndaluara:

- Ushtrimi pa leje mjedisore i veprimtarive, që kapërcejnë nivelin kufi të zhurmave, duke prishur qetësinë dhe pushimin e njerëzve në mjedise të jashtme apo të brendshme.
- Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i pajisjeve dhe makinerive pa dokumentacionin, që tregojnë nivelin e zhurmës që lëshojnë.
- Rënia e borive dhe krijimi i zhurmave të tjera në mjedise të qeta, të shpallura të tilla me akt nënligjor nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore.
- Instalimi dhe funksionimi, në katet përdhese të ndërtesave të banimit, i veprimtarive të punimit të drurit, të metaleve, riparimit të pajisjeve e makinerive, i lokaleve të zhurmshme, i altoparlanteve e veprimtarive të tjera, të ngjashme me to, që lëshojnë zhurmë mbi nivelin kufi për mjediset e banimit.

Neni 28 - Kontrolli

Kontrolli për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, ushtrohet mbi:

- burimet e zhurmës, të veprimtarive të pajisura me leje mjedisore;
- çdo burim zhurme në mjediset urbane të qyteteve dhe fshatrave, kur ka ankesë me shkrim;
- objektet në ndërtim, rikonstrukcion dhe para vënies në shfrytëzim;
- mjetet e transportit.

Neni 29 - Organet e kontrollit

- Kontrolli i zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe i akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, kryhet nga Inspektorati i Mjedisit, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës, struktura përgjegjëse për kontrollin e mjedisit e bashkisë/komunës dhe Inspektorati i Kontrollit të Automjeteve.
- Organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni ushtrojnë kontroll për zhurmën, në përputhje me dispozitat e akteve ligjore, që kanë miratuar krijimin dhe funksionimin e tyre.
- Personat fizikë e juridikë, gjatë kontrollit të veprimtarisë së tyre, krijojnë të gjitha kushtet për zhvillimin normal të kontrollit.

Neni 30 - Vendimi i kontrollit

- Në mbështetje të kontrollit të ushtruar, grupi i kontrollit evidenton situatën dhe problemet, cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes, ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative dhe, sipas rastit, vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të përkohshme të veprimtarisë.
- Rezultatet dhe vendimi i kontrollit i njoftohen subjektit të kontrolluar dhe organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet veprimtaria e kontrolluar. Një përmbledhje e vendimit të kontrollit vihet në dispozicion të publikut për 1 muaj, duke u depozituar në organin e qeverisjes vendore përkatëse.

Neni 31 - Masat gjatë kontrollit

Gjatë kryerjes së kontrollit, grupi i kontrollit urdhëron:

- kryerjen e matjeve të zhurmës së veprimtarive të personave fizikë apo juridikë, që përdorin burimin e zhurmës në një mjedis ku punojnë ose qëndrojnë njerëz;
- zbatimin e masave të kërkuara për mbrojtjen nga zhurma;
- ndalimin e përdorimit të ndërtesave, të reja apo të rikonstruara, derisa në to të zbatohen masat për mbrojtjen nga zhurma;
- ndalimin e përdorimit të burimit të zhurmës, derisa të jenë zbatuar tërësisht masat për mbrojtjen nga zhurma;

- ndalimin e veprimtarive të zhurmshme, që prishin pushimin dhe qetësinë e natës, nëse këto nuk mund të arrihen duke zbatuar masat e marra;
- ndërprerjen e punës dhe të veprimtarive që lëshojnë zhurmë, nëse kanë filluar pa miratimin e organit përkatës se janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma.

Në rast kundërshtimi për zbatimin e masave të mësipërme, bashkëpunohet me Policinë e Shtetit dhe me policinë e bashkisë/komunës.

Lista e akteve ligjore për kontrollin dhe menaxhimin e zhurmës

- Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmave në mjedis”
- VKM nr. 587 datë 07.07. 2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë Nr.9, date 27.11.2007 “Për kufizimin e nivelit të zhurmave në mjedis të caktuara”.
- Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit Nr.1073/1, date 12.04.2011 “Vlerësimin dhe menaxhimin e nivelit të zhurmave”.
- Udhëzimi nr. 1 datë 7.1.2013 “Për kërkesat minimale të hartëzimit strategjik të zhurmës”.
- Udhëzimi nr. 2 datë 7.1.2013 “Për treguesit, mënyrat e vlerësimit, rregullat, kërkesat teknike dhe metodike për vlerësimin e nivelit të zhurmës, si dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e gjendjes”.
- Urdhër i Ministrit të Mjedisit Nr.234, datë 25.05.2015 “Për miratimin e rregullave për monitorimin e zhurmave dhe efektet në shëndet”.
- Udhëzimi nr. 1 datë 19.02.2018 i Ministrit të Turizimit dhe Mjedisit “Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”.

Udhëzimi Shqiptar Nr.8, datë 27.11.2007 “Për kufijtë e niveleve të zhurmës në zona të caktuara” që mbështesin Ligjin Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore”, përcakton nivelet e pragut gjatë ditës jashtë banesave ndërtesa në 50 deri 55 dB (A). Këto nivele udhëzuese do të merren parasysh nga Kontraktori i Ndërtimit kur përcaktoni Planin e Menaxhimit të Zhurmës dhe zbatimin e tij. Kërkohej një planifikim adekuat i aktiviteteve të ndërtimit për të kompensuar nivelet e zhurmës sa më shumë që të jetë e mundur.

Tabela 1: Vlerat udhëzuese për zhurmën e komunitetit sipas legjislacionit shqiptar

Mjedisi specifik	Efektet kritike të shëndetit	L _{AeqdB(A)}	Koha	L _{AmaxdB(A)}
Zonë banimi				
Jashtë banesës	Shqetësim serioz gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	--
	Shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50		--
Brenda banesës	Kuptimi i bisedave dhe shqetësimi imoderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes.	35	16	--
Brenda dhomës së gjumit	Prishja e gjumit gjatë natës.	30	8	--
Jashtë dhomës së gjumit	Prishja e gjumit, dritarja e hapur (jashtë normave) (5).	45	8	--60

Institucione				
Mësimdhënie në klasë, institucione parashkollore (brenda)	Kuptimi i bisedave, vështirësitë në drejtim të informacionit, komunikimi i mesazhit	35	Gjatë mësimit	--
Dhomat e fjetjes në kopshtin e fëmijëve	Prishja e gjumit	30	Koha e gjumit	--
Oborri i shkollës, zonat e lojërave të shkollës	Shqetësim - burime të jashtme	55	Koha e pushimit	--
Spitali, sallat, dhomat (brenda)	Prishja e gjumit gjatë natës	30	8	40
	Prishja e gjumit gjatë ditës dhe mbrëmjes	30	16	
Spitalet, dhomat e trajtimit (brenda)	Ndikimi në pushim, rimëkëmbja	(1)		
Fushat e veprimtarive shoqërore - ekonomike				
Zonat industriale, tregtare, trafiku (brenda dhe jashtë)	Dëmtimi i dëgjimit	70	24	110
Mjedisi specifik	Efektet kritike të shëndetit	LAeqdB(A)	Koha	LAmaz dB(A)
Mjedisi urban				
Mjedisi publik, brenda ose jashtë	Dëmtimi i dëgjimit	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argëtim	Dëmtimi i dëgjimit (klientë <5 herë/vit)	100	4	110
Dëgjimi i muzikës përmes kufjeve	Dëmtimi i dëgjimit	85 (4)	1	110
Tinguj impulsivë - zhurma e fishkëzjarreve dhe armëve të zjarrit	Dëmtimi i dëgjimit (të rriturit)			140 (2)
	Dëgjimi i dëmtuar (fëmijët)			120 (2)
Parqe publike				
Parqet publike dhe zonat e mbrojtura	Prishja e qetësisë	(3)		
<ol style="list-style-type: none"> sa më të ulëta të jetë e mundur; presioni maksimal i zërit (jo LAmaz, i shpejtë), i matur 100 mm nga veshi; zonat ekzistuese të qeta në natyrë duhet të ruhen dhe raporti i zhurmës së papërshtatshme me zërin e sfondit natyror duhet të jetë i ulët; nën kufje, të përshtatura për vlerat e fushës së lirë; perceptimi i zhurmës në dhomën e gjumit me dritare të hapura. 				

Burimi: Udhëzimi Nr.8 "Për kufijtë e niveleve të zhurmës në zona të caktuara", datë 27.11.2007

Vendim i Këshillit Bashkiak nr.156, datë 21.12.2018 "Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë".

Neni 1 – Objekti dhe qëllimi

- *Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt juridik, individ fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në Bashkinë e Tiranës.*
- *Ky vendim përcakton kundërvajtjet administrative për shkeljen e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore në fushën e sigurisë publike, qetësisë dhe moralit publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to.*
- *Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimin e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës të përcaktuara në legjisllacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë së Tiranës, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që cënojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.*

Neni 9 - Kundërvajtjet administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës

Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime:

- Shkaktimi i zhurmave shqetësuese në mjediset publike nga muzika në bar-kafe, restorante dhe/ose lokale të tjera shërbimi, jashtë orareve të përcaktuara nga lejet përkatëse dhe legjisllacioni në fuqi;
- Shkaktimi i zhurmave shqetësuese të çfarëdo lloji në ambientet e përbashkëta të banimit;
- Shkaktimi i zhurmave shqetësuese, në zonat e banuara nëpërmjet borive, muzikës së lartë të kasetofonëve në makina;
- Shkaktimi i zhurmave shqetësuese nga punimet/ndërtimet në mjediset publike dhe private, të kryera jashtë orareve të përcaktuara nga rregullat e fqinjësisë së mirë apo pa miratimin e organit përgjegjës publik;
- Djegia e mbeturinave apo ndezja e zjarreve në zonat e banuara, lulishte apo parqe në vende të papërcaktuara për këtë qëllim dhe pa lejen e strukturave përgjegjëse;
- Përdorimi i materialeve apo sendeve të ndryshme imituese, tymuese, rrezeve laser në ambiente të hapura dhe të mbyllura publike;
- Kryerja e garave të hipizmit në mjediset publike në qendrat urbane, parqe e lulishte në vende të pa u miratuara për këtë qëllim nga organi përgjegjës publik;
- Zhvillimi i lojërave me top apo lojërave të tjera që cënojnë sigurinë dhe qetësinë në zonat e pushuesve në hapësira publike apo ambientet e përbashkëta, përveçse kur këto zhvillohen me leje të strukturës përgjegjëse apo në mjediset të posaçme të përcaktuara për këtë qëllim;
- Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje parashikuar në aktet nënligjore të miratuara nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Tiranës.

Standardet e makinerive dhe pajisjeve që çlirojnë zhurmë

Standardet teknike të mbrojtjes nga zhurma përfshijnë respektimin e normave teknike, si për pajisjet zhurmuese, por dhe për materialet ndërtimore të ndërtesave që të mund të mundësojnë izolimin akustik. Në tërësi objektet e banesat në Tiranë (me përjashtim të disa ndërtimeve të reja) nuk kanë izolimin e duhur akustik çka përbën një tjetër vështirësi në sigurimin e qetësisë së duhur në brendësi të banesave veçanërisht atyre të ekspozuara në rrugët e transportit rrugor.

Po ashtu një standard tepër i rëndësishëm për kontrollin e zhurmave është dhe niveli teknologjik i emetimit të zhurmës për pajisje që çlirojnë zhurmë. Këto standarde përcaktojnë nivelin e lejuar të zhurmës që duhet të çlirojnë disa pajisje të caktuara. Për të verifikuar

këtë standard legjislacioni⁵ kërkon dhe markimin e tyre sipas kodit të konformitetit "CE". Këto standarde hartohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve (DPS) bazuar në normat e BE⁶ dhe zbatohen nga agjencitë dhe inspektoriatit përkatës (Inspektoriat Shtetëror i Mbrojtjes së Tregut⁷).

- Ligji nr.10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" dhe amendimet përkatëse.
- Ligj nr. 9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar, kërkon certifikimin e izolimit akustik të materialeve të ndërtimit. Ky certifikim bëhet në përputhje me ligjin 10489/2011.
- Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit". Punimet e ndërtimit duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë mbrojtjen nga zhurmat. Vlerësimi i përmbushjes e kriterëve bëhet nga Oponenca Teknike gjatë miratimit të lejeve ndërtimore dhe nga inspektimi dhe kualidimi final i objektit.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1063, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Mbi emetimin e zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura". Lista e pajiseve, subjekt i këtij vendimi, përfshin: vinça, kompresore, gjeneratore, makineri ndërtimi, motorkorrëse bari etj.

Zbatimi i këtyre standardeve teknologjike synon të sigurojë nivele emetimi brenda normave nga makineritë, megjithatë sfida qëndron në harmonizimin e burimeve të njëkohëshme të zhurmës në zona urbane çka mbetet dhe sfida kryesore e institucioneve vendore dhe qendrore.

Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 156, datë 21.12.2018 "Për përcaktimin e disa kundrvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për të në territorin Bashkisë Tiranë".

Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt juridik, individ fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në Bashkinë e Tiranës. 2. Ky vendim përcakton kundrvajtjet administrative për shkeljen e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore në fushën e sigurisë publike, qetësisë dhe moralit publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundrvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to. 3. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimi e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë së Tiranës, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundrvajtjeve administrative që çenojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

Neni 9- Kundrvajtjet administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës.

1. Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundrvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime:

- a. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese në mjediset publike nga muzika në bar-kafe, restorante dhe/ose lokale të tjera shërbimi, jashtë orareve të përcaktuara nga lejet përkatëse dhe legjislacioni në fuqi;*

⁵ Ligji nr.10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore"

⁶ Direktiva 2000/14/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 8 maj 2000, "Mbi emetimin e zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura"

⁷ <http://ishmt.gov.al/te-pergjithshme-2/?lang=en>

- b.** Shkaktimi i zhurmave shqetësuese të çfarëdo lloji në ambientet e përbashkëta të banimit;
- c.** Shkaktimi i zhurmave shqetësuese në zonat e banuara nëpërmjet borive, muzikës së lartë të kasetofonëve në makina;
- ç.** Shkaktimi i zhurmave shqetësuese nga punimet/ndërtimet në mjediset publike dhe private, të kryera jashtë orareve të përcaktuara nga rregullat e fqinjësisë së mirë apo pa miratimin e organit përgjegjës publik;
- d.** Djegia e mbeturinave apo ndezja e zjarreve në zonat e banuara, lulishte apo parqe në vende të papërcaktuara për këtë qëllim dhe pa lejen e strukturave përgjegjëse;
- e.** Përdorimi i materialeve apo sendeve të ndryshme imituese, tymuese, rrezeve laser në ambiente të hapura dhe të mbyllura publike;
- f.** Kryerja e garave të hipizmit në mjedise publike në qendrat urbane, parqe e lulishte në vende të pa u miratuara për këtë qëllim nga organi përgjegjës publik;
- g.** Zhvillimi i lojërave me top apo lojërave të tjera që çënojnë sigurinë dhe qetësinë në zonat e pushuesve në hapësira publike apo ambientet e përbashkëta, përveçse kur këto zhvillohen me leje të strukturës përgjegjëse apo në mjedise të posaçme të përcaktuara për këtë qëllim;
- h.** Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje parashikuar në aktet nënligjore të miratuara nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Tiranës.

Gjetje kyçe për rolin e Bashkisë Tiranë për zbatimin e kuadrit ligjor për zhurmat:

- Siç pasqyrohet dhe në nenet ligjore mësipër, Bashkitë kanë tashmë një sërë kompetencash dhe përgjegjësish ligjore për të forcuar zbatimin e rregullave për menaxhimin e zhurmave. Pavarësisht disa mungesave të caktuara ligjore, strukturat e Bashkisë duhet të forcojnë zbatimin e rregullave ekzistuese, si ato në nenet 8.9.10.11 dhe 18 dhe të kërkojnë nga Qeveria plotësimin e akteve nënligjore që pengojnë zbatimin e ligjit dhe ushtrimin e funksioneve të Bashkisë si neni 13, 14 dhe 15. Po ashtu është i nevojshëm një zgjerim i kompetencave të organeve vendore në rregullimin e liçencimit e aktiviteteve me zhurmë. Për këtë qëllim nevojiten ndryshime në ligjin kuadër Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmave në mjedis”.
- Kuadri ligjor kombëtar përcakton detyra e përgjegjësi për pushtetin vendor. Përgjegjësitë direkte përfshijnë; hartimin e instrumenteve institucionale siç është dhe ky Plan Veprimi për Kontrollin e Zhurmave.
- Bashkia Tiranë duhet të sigurojë kapacitetet njerëzore dhe logjistike për zbatimin e detyrimeve që përcakton legjislativi, përfshi dhe një regjistër të përditësuar të aktiviteteve që çlirojnë zhurma. Strukturat inspektuese në terren të Bashkisë duhet të adresojnë çdo shqetësim që lidhet me zhurmat në komunitet duke mbikëqyrur vazhdimisht subjektet që krijojnë shqetësime në komunitet (veçërisht baret në zonat urbane).
- Kuadri ligjor aktual për menaxhimin e zhurmës përcakton kompetencë dhe përgjegjësi të organeve vendore për zbatimin e ligjit dhe mundësinë bashkive që të krijojnë dispozitat e duhura ligjore me karakter vendor për zbatimin e ligjit (rregulloret etj.).
- Në rast të mungesës së kompetencës ligjore për dispozita të caktuara që lidhen me inspektimin apo certifikimin e konformimitit Bashkia, Tiranë duhet të ndërtojë një mekanizëm bashkëpunimin me institucionet kompetente siç është, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit (AKM) apo dhe Inspektoriati Shtetëror i Mbrojtjes së Konsumatorit. Zbatimi i kuadrit ligjor për zhurmat kërkon koordinim efektiv midis qeverisjes vendore dhe asaj qendrore dhe funksionimi i këtij koordinimi është detyrim i këtyre strukturave qeverisëse.
- Bashkia Tiranë duhet të garantojë që miratimi i lejeve për aktivitetet me zhurmë (leje ndërtimi etj.) që miratohen nga institucionet qendrore të sigurojnë qetësinë e normat e miratuara për kontrollin e zhurmës. Për këtë çështje kërkohen kritere dhe koordinim i vazhdueshëm dhe efektiv midis Bashkisë Tiranë dhe agjencive të tjera lejedhënëse. Lejet e miratuara duhet të përcaktojnë kushte dhe orare për kufizimin e aktiviteteve me zhurmë (bareve, punishteve etj.). Rekomandohet që kuadri ligjor aktual i zhurmave t'i japë më shumë kompetenca qeverisjes vendore.

Planet dhe programet rajonale, kombëtare dhe vendore, të zhvillimit urban, infrastrukturës etj. zbatimi i të cilave kërkon menaxhimin e zhurmës në mjedis

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) “Shqipëria 2030” është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë. Në bazë të parimeve, objektivave dhe specifikimeve të tij do të detajohen planet e hierarkive më të ulëta, Planet kombëtare sektoriale (PKS), Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare (PDZK), Planet për zhvillimin rajonal (PZHR), Planet sektoriale në nivel qarku (PSNQ), Planet e përgjithshme vendore (PPV) dhe çdo instrument tjetër planifikimi territorial, që buron si rrjedhojë e nevojave për zhvillim.

Pol i zhvillimit rajonal Tiranë - Durrës, motori ekonomik qendror

Hapësira Tiranë–Durrës cilësohet si motori i ekonomisë së vendit. Një pol i rëndësishëm i zhvillimit rajonal, i cili mbështetet në parimet e konkurrencës ekonomike globale, në krijimin e klasterave ekonomike dhe në zhvillimin metabolik të territorit.

Plani përcakton vizionin kombëtar dhe ndërthurjen rajonale të tij duke krijuar një kohenzion për zhvillimin e integruar të vendit dhe ndërlidhjen infrastrukturore të qendrave kryesore rajonale⁸.




Figura 1: Poli i zhvillimit rajonal Tiranë – Durrës (Burimi: Durana)

Strategjia dhe Plani i Veprimit Kombëtar të Transportit (SPVKT) 2016- 2020⁹ u miratua me VKM 811, datë 16.11.2016 dhe përbën politikën më të rëndësishme të transportit në vitet e fundit, e cila vijon me programet e mëparshme kombëtare, është në përputhje me objektivat dhe prioritetet e BE-së dhe bazohet në një situatë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të Sektorit Shqiptar të transportit, duke marrë parasysh rrjetet infrastrukturore, rregulloret dhe instrumentet financiare. Strategjia e Transportit krijon një sërë vizionesh, prioritetesh strategjike dhe qëllimesh do të materializohen përfundimisht përmes një plani veprimi me 43 linja prioritare. Ato janë vlerësuar me anë të indikatorëve kyç të performancës, vlerësimit të buxhetit, kalendarit, burimeve financiare, palëve të interesuara, etj. Lidhur me territorin e Bashkisë Tiranë SPVKT përfshin masa për një sërë aksesh rrugore të tilla si: Ndërtimi i bypassit të Tiranës; rindërtimi i Rrugës Tiranë – Durrës me drejtim Tiranë – Ndroq – Plepa; përfundimi i rrugës Tiranë – Elbasan; ndërtimi i Rrugës së Arbërit; përfundimi i Rrugës së

⁸ Referohu ne “Harta e sistemit urban dhe ndërlidhjes hapësinore” Harta 4.1, faqe 158 e PKK

⁹ Miratuar me VKM nr. 811 date 16.11.2016

Unazës së Jashtme të Tiranës (seksioni verior); zgjerimi i Autostradës Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i autostradës Kashar – Rogozhinë.

Plani i Përgjithshëm Vendor Tirana 2030, miratuar zyrtarisht në shkurt 2017. Plani synon të hapë një epokë të re për Tiranën, duke përfshirë zhvillimin e kontrolluar, infrastrukturën e përparuar, korridoret e gjelbra dhe një përmirësim të trashëgimisë arkitektonike të qytetit. Ky plan lokal është shkruar duke marrë seriozisht parasysh objektivat strategjike të përshkuara në Planin e Përgjithshëm Kombëtar. Vizioni strategjik për Tirana 2030 është strukturuar në 10 shtylla, 23 politika kryesore dhe 13 projekte strategjike. Disa prej elementeve kryesore, sa i takon lëvizshmërisë urbane, janë: a) Krijimi i një qendre transporti multimodal në Tiranë me lloje të ndryshme të transportit publik; b) arritja e dy unazave të gjelbra dhe të qëndrueshme (2 dhe 4), parqe lineare kushtuar këmbësorëve, çiklizmit, transportit publik dhe lëvizshmërisë së butë; c) Kompletimi i rrjetit të transportit publik në qendër të qytetit me një linjë rrethore përgjatë unazës së 4-t dhe një linjë transporti publik përgjatë bulevardit “Dëshmorët e Kombit”; d) stimulimi i gjithë lëvizshmërisë së përbashkët (me biçikleta, makinë, skuterë ...) dhe mënyrave të qëndrueshme të transportit (automjete elektrike dhe hibride) në mënyrë që të garantohet një lëvizshmëri e shëndetshme dhe ekologjike për qytetarët; e) përcaktimi i zonave të kufizuara të trafikut në favor të këmbësorëve brenda unazës së parë dhe sistemi i lëvizjes së përbashkët brenda unazës së 4-t; f) përfundimi i unazës së 5-të për transport të rëndë dhe përfundimi i një sistemi parku dhe udhëtimi përgjatë hyrjeve kryesore në qytet; g) arritja e një rrjetit hekurudhor me shpejtësi të lartë që lidh qendrën e qytetit me aeroportin dhe portin.

Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane (PLQU) për Bashkinë e Tiranës¹⁰. Ky dokument i organizuar në tri vëllime prezanton hartimin e Planit të parë të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane të Tiranës. Procesi i miratuar i planifikimit është koherent me qëllimin dhe veprimtaritë e projektit SUMSEEC¹¹ II dhe shtjellohet mbi konceptin dhe qasjet e PLQU-së të zhvilluara në Bashkimin Evropian. Procesi filloi me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit (MM) midis GIZ-it dhe Bashkisë së Tiranës në qershor 2019 dhe është në linjë me udhërrëfyesin e SUMSEEC II, që përmbledh njohuritë dhe instrumentet ekzistuese të politikave për të zhvilluar lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane në vendet e Evropës Juglindore, mbështetur në efikasitetin energjitik dhe mbrojtjen e mjedisit dhe duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore. Nga pikëpamja gjeografike, PLQU-ja e Tiranës përqendrohet në pjesën e brendshme të qytetit, që përkon me vijën e mëparshme kufizuese të bashkisë, domethënë përpara reformës administrativo-territoriale të vitit 2014. Koncepti i PLQU-së nxit planifikimin afatgjatë, ndaj masat e propozuara për ndërhyrje janë planifikuar në tri faza kohore, si më poshtë: a) afatshkurtra: 2 vjet (2022), b) afatmesme: 5 vjet (2025); c) afatgjata: 10 vjet (2030).

Plani i Veprimit i Qytetit të Gjelbër¹² (GCAP) u përgatit nga ARUP-i dhe u hartua në përputhje me metodologjinë e zhvilluar për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) nga ICLEI dhe OECD-ja. Ai përfundoi në Prill të vitit 2018. Plani ofron një vizion për Tiranën dhe një grup konkret masash për të trajtuar sfidat mjedisore që parashikohet të prekin Tiranën gjatë viteve të ardhshme dhe për të siguruar investime për projektet prioritare të infrastrukturës mjedisore. Ai trajton çështje mjedisore me të cilat përballet qyteti, të tilla si: ndotja e ajrit, rritja urbane, energjia e rinovueshme dhe riciklimi. Plani përcakton objektiva për përmirësimin e sistemit të transportit në qytet si një ndër faktorët kryesorë me ndikim në mjedis.

¹⁰ https://www.tirana.al/uploads/2020/12/20201203125543_sump_tirana-volume-i_status_analysis_200806_final_alb.pdf

¹¹ Sustainable Urban Mobility in South-East European Countries II

¹² https://www.tirana.al/uploads/2019/1/20190110145642_final-gcap-shqip.pdf

Gjetje kyçedhe rekomandime për zbatimin e planeve kombëtare dhe vendore

- Kuadri i planeve parashikon zhvillimin e territorit në elementet urbane, ekonomike dhe sociale. Planet e nivelit kombëtar si Plani Kombëtar Territorial dhe Plani Kombëtar i Transportit përcaktojnë drejtimet dhe zonat kryesore të zhvillimi ekonomik, social dhe ekonomik. Këto plane me karakter kombëtar kanë ndikim në territorin e Bashkisë Tiranë, kryesisht nëpërmjet zhvillimit dhe rritjes së fluksit të transportit. Në zbatimin e Planeve Kombëtare, kompetencat e Bashkisë Tiranë janë të kufizuara, megjithatë Bashkia mund dhe duhet të krijojë një platformë apo mekanizëm bashkëpunimi me organet qendrore që miratojnë projektet me karakter kombëtar (siç janë akset e reja rrugore). Bashkia duhet të kërkojë që në këto projekte të kryhet një analizë profesionale e zhurmave që këto projekte gjenerojnë, si dhe të kërkojë masa teknike për reduktimin e tyre. Bashkia duhet të kërkojë të njihet dhe vlerësojë këto projekte duke dhënë dhe mendimet e kërkesat e saj përpara se ato të miratohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar apo dhe Këshilli Kombëtar Territorial. Në zbatimin e projekteve kombëtare në territorin e Bashkisë Tiranë, administrata e Bashkisë mund të monitorojë zbatimin e tyre dhe, sidomos në marrjen e masave teknike e operacionale për reduktimin e zhurmave si në ndërtimin e tyre (përcaktimin i orareve të punës sipas ligjit) dhe gjatë funksionimit (p.sh. vendosja e barrierave zhurmë kapëse dhe efikasiteti i tyre).
- Sa i takon planeve me karakter vendor si Plani Tirana 2030, zbatimi i këtij plani gjeneron zhurma, sidomos në zhvillimin e sistemit urban pra të ndërtimeve dhe atë të transportit urban dhe ndërrurban (lidhja e njësisve rurale me Tiranën). Po ashtu një burim tjetër i rëndësishëm i zhurmave janë dhe aktivitetet ekonomike të qytetit dhe, sidomos baret e punishteve të përhapura gjerësisht në objekte të banuara (katet e para). Në zbatimin e planeve vendore (nëpërmjet projekteve të veçanta) Bashkia duhet të imponojë izolimin akustik në të gjitha objektet e reja që miraton, si dhe të sigurohet që aktivitetet sociale e ekonomike që zhvillohen në mjediset urbane të respektojnë normat e rregullat për nivelet e zhurmës. Për këtë qëllim administrata e Bashkisë duhet të krijojë një bazë të dhënash për aktivitetet që gjenerojnë zhurma dhe t'i monitorojë vazhdimisht ato nëpërmjet inspektimeve rastësore; përparësi duhet t'u jepet mbikëqyrjes së bareve dhe punishteve në godinat e banimit.

Politikat e Bashkimit Evropian dhe ato kombëtare lidhur me zhurmat dhe nevoja e përshtatjes së planeve të veprimit në përmbushje të këtyre politikave

Politika e BE-së

Ndotja nga zhurma është një shqetësim i madh i shëndetit në Evropë. Ajo shkaktohet nga zhurma që vjen nga një sërë burimesh dhe është gjerësisht e pranishme jo vetëm në mjediset më të ngarkuara urbane, por gjithnjë e më shumë në mjedise dikur natyrore.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e ka klasifikuar zhurmën e trafikut, duke përfshirë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, si shkaktarin e dytë¹³ më të rëndësishëm të shëndetit të keq në Evropën Perëndimore, pas ndotjes së ajrit të shkakuar nga grimcat shumë të imta¹⁴.

¹³ WHO and JRC, 2011, Burden of disease from environmental noise — quantification of healthy life years lost in Europe, World Health Organization, Geneva, Switzerland accessed 5 May 2014.

¹⁴ Hänninen, O., et al., 2014, 'Environmental Burden of Disease in Europe: Assessing Nine Risk Factors in Six Countries', Environmental Health



Burimi: Faqja elektronike e Komisionit Evropian

Ekspozimi i zgjatur ndaj zhurmës mund të çojë në efekte negative kardiovaskulare dhe metabolike, ulje të performancës njohëse te fëmijët, si dhe bezdi të rëndë dhe shqetësim të gjumit¹⁵. Ekspozimi afatgjatë ndaj zhurmës vlerësohet se shkakton 12000 vdekje të parakohshme dhe kontribuon në 48000 raste të reja të sëmundjeve ishemike të zemrës në vit në territorin evropian. Është vlerësuar se 22 milionë njerëz vuajnë nga bezdi kronike të larta dhe 6.5 milion njerëz vuajnë nga shqetësime kronike të larta të gjumit. Si rezultat i zhurmës së avionëve, 12500 nxënës të shkollave vlerësohet se vuajnë nga dëmtimi i të mësuarit në shkollë.

Rreth 113 milionë evropianë janë prekur nga ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve të zhurmës së trafikut ditë-mbrëmje-natë prej të paktën 55 decibel. Përveç kësaj, 22 milionë evropianë janë të ekspozuar ndaj niveleve të larta të zhurmës nga hekurudhat, 4 milionë në nivele të larta të zhurmës së avionëve dhe më pak se 1 milion në nivele të larta të zhurmës së shkaktuar nga industria. Ajo që shumë njerëz mund të mos e dinë është se ekspozimi afatgjatë ndaj zhurmës, edhe në nivelet me të cilat jemi mësuar në zonat urbane, ka ndikime të rëndësishme shëndetësore. Në shumicën e vendeve evropiane, më shumë se 50% e njerëzve që jetojnë në zonat urbane janë të ekspozuar ndaj niveleve të zhurmës në rrugë prej 55 decibel ose më të lartë gjatë periudhës së matur ditë-mbrëmje-natë.

Emetimet e zhurmës në burim janë rregulluar në BE prej shumë vitesh. Kufijtë maksimalë të zhurmës për mjetet motorike, pajisjet shtëpiake dhe pajisjet e jashtme datojnë që nga vitet 1970. Kohët e fundit, masat për të kontrolluar zhurmën nga aeroportet dhe rregullimi i niveleve të zhurmës së veprimtarive industriale kanë zgjeruar kontrollin e zhurmës mjedisore.

Prezantimi i Direktivës për Zhurmën Mjedisore

Direktiva prezantoi dy tregues kryesorë për shqetësimin e gjumit, të cilët, nëse tejkalohen, kërkojnë hartimin e planeve të veprimit që janë krijuar për të zvogëluar ekspozimin dhe mbrojtur zonat që ende nuk janë ndotur nga zhurma. Qëllimi i Direktivës së Zhurmës Mjedisore 2002/49/EC është të përcaktojë një qasje të përbashkët që synon të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë në bazë të përparësive efektet e dëmshme, përfshirë bezdinë, për

shkak të ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore dhe për të siguruar një bazë për zhvillimin e BE-së masat për të zvogëluar zhurmën e emetuar nga burimet kryesore, në veçanti automjetet rrugore e hekurudhore dhe infrastrukturën, avionët, pajisjet e jashtme dhe industriale dhe makineritë e lëvizshme. Qëllimi mund të arrihet nëse ndërmerren veprimet e mëposhtme nga shtetet anëtare:




Figura 2: Ilustrim i ndikimit nga zhurma mjedisore në Evropë (Burimi: EEA report - Noise in Europe 2020; EEA Infographic)

Perspectives 122(5), pp. 439-446 (DOI: 10.1289/ehp.1206154).

¹⁵ WHO, 2018, [WHO environmental noise guidelines for the European region](#), World Health Organization, Regional Office for Europe, Copenhagen accessed 7 December 2018.

- zhurma mjedisore të përcaktohet përmes hartës së zhurmës, nga metodat e zakonshme të vlerësimit për shtetet anëtare;
- informacioni të vihet në dispozicion të publikut;
- miratimin e planeve të veprimit me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës mjedisore aty ku është e nevojshme dhe, veçanërisht, kur nivelet e ekspozimit mund të shkaktojnë efekte të dëmshme në shëndetin e njerëzve.

Komisioni Evropian e ka identifikuar zhurmën si një nga problemet më urgjente në zonat urbane në të gjithë Evropën dhe theksoi nevojën për të ndërmarrë veprime mbi burime të ndryshme të zhurmës, si pjesë e planit të tij të veprimit mjedisor në 1993. “Politika e mëvonshme e zhurmës” pasuese përcakton hapa për zhvillimin e një direktive për të rregulluar në mënyrë specifike zhurmën e krijuar nga pajisjet në natyrë.

Programi i Shtatë i Veprimit Mjedor i BE-së (PAP-i i 7-të) nënvizoi faktin se shumica e evropianëve që jetojnë në zonat kryesore urbane janë të ekspozuar ndaj niveleve të larta të zhurmës, si pasojë e të cilëve shpesh shfaqen efekte negative shëndetësore. Më tej PAP i 7-të përmbante objektivin që deri në vitin 2020, ndotja e zhurmës në BE do të kishte rënë ndjeshëm, duke iu afruar niveleve të rekomanduara nga OBSH. Për të arritur këtë objektiv, duhej të zbatohesh një politikë e përditësuar e BE -së për zhurmën, në përputhje me njohuritë më të fundit shkencore dhe masa për të zvogëluar zhurmën në burim, përfshirë përmirësimet në planifikimin e qyteteve.

Politika kombëtare për menaxhimin e zhurmës

Kuadri institucional¹⁶

Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” ka si fushë zbatimi ndërhyrjen për çdo zhurmë që tejkalon normat kufi dhe paraqet rrezikshmëri për shëndetin. Ligji përcakton si përgjegjës për kontrollin e zbatimit të tij nga persona fizikë e juridikë, veprimtaritë e të cilëve çlirojnë zhurmë, si dhe nga vetë qytetarët, organet shtetërore qendrore dhe vendore, sipas detyrave të përcaktuara nga ky ligj. Referuar Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, problematika e ndotjes akustike është përgjegjësi e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucioneve të tyre të varësisë (përkatesisht AKM, ISHMPUT dhe ISHP), si dhe Njësitë të Qeverisjes Vendore.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (MTM) është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për menaxhimin e ndotjes akustike. Objektivat e këtij institucioni synojnë në menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave me qëllim respektimin e niveleve të lejuara, hartimi i planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave, marrjen e masave për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor. Gjithashtu MTM organizon ngritjen e grupeve të punës dhe Task Forcave për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për menaxhimin e zhurmave në mjedis. Drejtoria e Mjedisit dhe Jetësisë të Prioritetëve (DMJP) në MTM është struktura përgjegjëse për menaxhimin e ndotjes akustike, e cila ka për detyrë: hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave dhe programeve lidhur me evidentimin dhe reduktimin e ndotjes akustike.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit¹⁷ ka si objektiva kryesorë hartimin e Raportit Vjetor të Gjendjes në Mjedis, bashkëpunimet ndër-institucionale për grumbullimin e informacioneve që kanë të bëjnë me tregues të caktuar mjedisorë, si dhe mirëmbajtjen dhe zhvillimin e laboratorit për kryerjen e analizave mjedisore. Ndër të tjera, ajo vlerëson natyrën, shkallën dhe rëndësinë e dëmeve të shkaktuara në mjedis, rrezikon ndaj shëndetit të njeriut dhe aftësinë e rehabilitimit natyror.

¹⁶ Burimi: Raporti i Performances për Ndotjes Akustike KLSH 2019

¹⁷ AKM është krijuar si ristrukturim i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve në mbështetje të ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” dhe VKM-së nr. 47, datë 29.01.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit

AKM është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve që jep në lejet përkatëse të mjedisit, menaxhon dosjet e subjekteve, të cilët dërgojnë të dhëna për vetëmonitorimin në përputhje me lejet përkatëse të mjedisit që zotërojnë dhe bashkëpunon me Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe me organizata të tjera ndërkombëtare mjedisore.

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit¹⁸ (ISHMPUT) ka në kompetencë të tij hartimin e raporteve periodike të indikatorëve të inspektimit, të cilat i dërgohen strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ky institucion siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore sipas parimit “Ndotësi paguan” dhe angazhohet në vendosjen e dënimeve administrative për shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen interesit publik në bazë të legjislacionit në fuqi. Inspektoriati, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret, duke vlerësuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

Instituti i Shëndetit Publik është një institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrit të Shëndetësisë, krijuar me ligjin nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, si një qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni. ISHP ushtron veprimtarinë e tij në fushat e mbikëqyrjes epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe jo infektive; menaxhimit të regjistrave kombëtarë, kërkimit shkencor në shëndetin publik; ndjekjes së të rejave shëndetësore ndërkombëtare, përfshirë sistemet dhe praktikat, trajnimin dhe edukimin universitar në shëndetin publik; informimin e popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik. Më specifiku në lidhje me ndotjen akustike, ky institucion ka si objektiv vlerësimin natyror, shkallën dhe rëndësinë e dëmeve të shkaktuara ndaj shëndetit të njeriut në zonat urbane nga ndotja akustike, organizon dhe kryen ekspertiza sanitare për vlerësimin e ndotjes akustike dhe elementeve të tjera të fizikës sanitare dhe shqyrton ankesat e ardhura për ndotësit e zhurmave, si dhe kryen ekspertizën përkatëse.

Bashkia Tiranë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm (DPMZHQ) është përgjegjëse për miradministrimin e çdo çështjeje që lidhet me zhvillimin e politikave, planeve për mbrojtjen e mjedisit urban, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së banorëve, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit të Tiranës dhe territoreve përreth. Ajo përshtat politikat kombëtare për mbrojtjen e mjedisit në nivelin e Bashkisë Tiranë duke përcaktuar objektivat e zhvillimit dhe indikatorët për matjen e realizimit të tyre në nivel lokal. Bashkia Tiranë, përmes DPMZHQ është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës¹⁹.

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Policia Bashkiake

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit të Ndotjeve në Mjedis ushtron detyrat në zbatim të Vendimit nr.156, datë 21.12.2018 të Këshillit Bashkiak, për “Përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”. Vizioni i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë, është njëkohësisht vizioni i Bashkisë Tiranë për mbrojtjen e konsumatorit të kryeqytetit, jo vetëm nëpërmjet monitorimit dhe evidentimit të rasteve, por të ushtrimit të kontrollit të vazhdueshëm, sqarimit të rrethanave dhe marrjes së masave shtrënguese, për rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar për një mjedis më të pastër, pa mbetje, ndotje akustike apo me respektimin e normave detyruese të bashkëjetesës dhe të sjelljes, me pikësynimin e qartë, të rritjes së standardeve të jetesës në qytetin e Tiranës. Sektori i Kontrollit të Ndotjeve në Mjedis, ka në zbatim të detyrave, monitorimin,

¹⁸ ISHMPUT është krijuar me VKM nr. 46 datë 29.01.2014 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të ISHMPUT” i ndryshuar, si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin

¹⁹ Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës, fq 34

kontrollin dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, në lidhje me ndotjet e ndryshme të shkaktuara nga qytetarët apo subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Tiranë.

Bazuar në sa më sipër, Bashkia Tiranë vepron sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 26 i të cilit “Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit” përcakton: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: a) Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja; b) Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. c) Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Plani kombëtar i veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis

Ky plan veprimi është miratuar nga Këshilli i Ministrave²⁰ (2011) dhe analizon e parashikon masa ligjore, administrative dhe organizative të domosdoshme për t'u ndërmarrë me qëllim të përmbushjes së kërkesave të ligjit për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis të kërkesave të direktivës bazë të BE, si dhe të direktivave të tjera të lidhura me këtë çështje me synimin e administrimit të qëndrueshëm dhe reduktimit të nivelit të zhurmave në mjedis. Objektivi kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Plani kombëtar i veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis, shërben si një dokument bazë dhe orientues për hartimin e planeve lokale të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis, kërkesë kjo që buron nga Neni 8 i ligjit për administrimin e zhurmave në mjedis, përgjegjësi kjo e njësive të qeverisjes vendore.

Në objektivat afatshkurtër të këtij plani veprimi synohet të përfshihen aktivitete dhe masa që kanë për qëllim përmirësimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor me direktivat e BE-së, ndërsa në planin afatgjatë parashikon objektiva dhe masa që lidhen me ndërhyrjen në sektorët e ndryshëm të ekonomisë me qëllim përmbushjen e standardeve të parashikuara për nivelet e lejuara të zhurmave në mjedis. Objekt i këtij plani veprimi janë sektorët kryesorë që gjenerojnë zhurma në mjedis, të cilët janë trajtuar njëkohësisht dhe nga direktivat e BE, që janë si më poshtë:

- Transporti (rrugor, ajror, hekurudhor);
- Aktivitete të shërbimit social (klubet e natës dhe diskot, baret, restorantet);
- Pajisje dhe makineri (përpunim metali, prerje metalesh, sharra, gjeneratorë, elektromotorë, kompresorë, çekiçë pneumatikë etj.).

Për të përcaktuar masat e domosdoshme për administrimin e zhurmave në mjedis është e domosdoshme analiza e situatës aktuale me sektorët e mësipërm. Kuadri ligjor rregullator për secilin sektor, boshllëqet ligjore apo institucionale, masat e domosdoshme për t'u ndërmarrë etj.

Gjetje kyçe dhe rekomandime për zbatimin epërgjegjësive institucionale

Referuar ligjit të zhurmave, Bashkia Tiranë ka përgjegjësinë e:

- përgatitjes dhe miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Zhurmën;
- procesit të hartëzimit të zhurmës;
- shpalljes së zonave të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe
- vendosjen e kufizimeve të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit dhe legjisllacionin në fuqi;
- mbikëqyrjes së zbatimit të kërkesave rregullatore për zhurmën nga ana e gjeneruesvetë zhurmës që janë subjekt i legjisllacionit për zhurmat;
- miratimit të rregullave lokale për menaxhimin e zhurmës (kantieri ndërtimore, klube etj.)

²⁰ VKM Nr. 123, datë 17.02.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit me menaxhimin e nivelit të zhurmave” -

3. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SITUATËS NË BASHKINË TIRANË NË LIDHJE ME MENAXHIMIN E ZHURMËS

Për të përcaktuar masat e domosdoshme për administrimin e zhurmave në mjedis është e domosdoshme analiza e situatës aktuale.

Gjatë 20 viteve të fundit institucione të ndryshme publike, por edhe shoqëria civile apo kompani private kanë dhënë informacione orientuese për nivelet e zhurmave në zona të ndryshme të Tiranës, e madje ka patur përpjekje (edhe pse disa herë të dyshimta për saktësinë) për një hartëzim të nivelit të zhurmave.

Duke vlerësuar përpjekjet, duhet theksuar se vlera si 132 dB të regjistruara në qytetin e Tiranës (vlera të publikuara në raportin vjetor 2021 të Projektit "Mushkëri të Gjelbra") janë mjaft larg realitetit – fizikisht (objektivisht) të pamundura të realizohen - nga të gjitha llojet e mundshme të burimeve dhe aktiviteteve, në çdo mjedis urban apo dhe në mega-qytetet e ndryshme në botë. Vlera 132 dB mund të regjistrohet vetëm në një aerodrom, shumë pranë një avioni reaktiv ushtarak në aktivitet.

Nëse do t'i referohemi vlerave të publikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis (2010) dhe të dhënave të sistemit të monitorimit të zhurmave nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", do të vihet re se vlera maksimale e regjistruar në disa nga pikat e aerodromit është 103 dB.

Nga seria e gjatë e monitorimeve të shqyrtuara nga burime të ndryshme, është zgjedhur të paraqitet një përmbledhje e raportimeve të monitorimeve të linjës së Institutit të Shëndetit Publik dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të cilat janë më afër realitetit. Në tabelat e mëposhtme jepen vlerat mestare vjetore të indikatorit të zhurmave LAeq ditë/natë gjatë viteve 2007-2020, për 15 Stacione monitorimi në qytetin e Tiranës.

Paraqitja e vlerave mesatare vjetore të LAeq Ditë, për 15 Stacione monitorimi në Tiranë për periudhën 2007-2020

Tabela 2: Niveli mesatar i zhurmave gjatë ditës (6.00 - 23.00), LAeq (dB)

Nr.	Stacionet e monitorimit	Niveli mesatar i zhurmave gjatë ditës (6.00 - 23.00), LAeq (dB)									
		2010	2011	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	
1	Shkolla e Bashkuar	72.7	65.6	63	66.21	62.35	65.86		61.7		
2	Farmacia Nr. 10	67	72.3	70.4	67.63	58.76	62.7		63.93		
3	Stacioni i Trenit	71.9	66.5	65.6	64.04	61.56	66.27		68.49		
4	Stadiumi Dinamo	71.2	70.6	64.5	59.45	60.32	62.86		69.74		
5	Shkolla "Edith Durham"	71.8	75	65	61.69	61.87	61.52		60.95		
6	Ish Banka Amerikane (Blloku)	61.4	60.9	62.9	63.47	58.65	63.1		64.22		
7	Kryqëzimi "Vasil Shanto"	71.2	81.2	66.7	66.39	64.59	66.3		68.35		
8	Kryqëzimi "21 Dhjetori"	70.5	72.4	69.4	68.41	67.97	64.19		66.17		
9	Kryqëzimi "Drejtorja e Policisë"	75	73.5	63.9	64.76	63.42	64.07		64.44		
10	Laprakë, kryqëzimi i spitalit	71.6	72.9	72.5	67.69	67.33	66.02		66		
11	Pallati i Kongreseve	65	69.2	66.4	64.27	63.8	66.94		65.31		
12	Partizani i Panjohur	68.4	71.4	70	67.35	67.42	70.14		71.45		
13	Kryqëzimi te Selvia	70.2	68.2	72	65.39	69.53	69.55		68.08		
14	Rruga e Elbasanit	74.4	75.1	74.3	71.16	73.81	73.8		72.59		
15	Sheshi Skënderbe	69.5	71.8	71.5	74.25	65.78	70.29		69.77		
Niveli mesatar sipas stacioneve të monitorimit			71.1	67.9	65.56	64.48	66.24	66.1	67.15	62.5	

(Përpunimi nga autorët, bazuar në RGJM)

Paraqitja e vlerave mesatare vjetore të LAeq Natë, për 15 Stacione monitorimi në Tiranë për periudhën 2007-2020

Tabela 3: Niveli mesatar i zhurmave gjatë natës (23.00 - 6.00), LAeq (dB)

Nr.	Stacionet e monitorimit	Niveli mesatar i zhurmave gjatë natës (23.00 - 6.00), LAeq (dB)								
		2010	2011	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Shkolla e Bashkuar	56.7	53.9	53.3	53.47	52.87	55.4		55.26	
2	Farmacia Nr. 10	63.2	62.7	63.3	53.44	51.23	56.81		55.66	
3	Stacioni i Trenit	60.6	55.6	52.8	61.63	52.61	51.69		58.47	
4	Stadiumi Dinamo	55.1	56.5	53.4	58.54	53.6	54.43		58.82	
5	Shkolla "Edith Durham"	60.3	59.5	53.9	58.07	60.41	59.95		57.89	
6	Ish Banka Amerikane (Blloku)	60.5	63.1	60.6	62.83	54.07	56.54		56.99	
7	Kryqëzimi "Vasil Shanto"	62.6	69.4	57.7	54.89	55.24	55.07		58.91	
8	Kryqëzimi "21 Dhjetori"	61.4	63.7	61.5	61.05	61.03	60.3		59.99	
9	Kryqëzimi "Drejtorja e Policisë"	53.4	52.6	53.1	53.67	52.47	53.86		54.42	
10	Laprakë, kryqëzimi i spitalit	63.1	63.2	61.8	60.03	65.18	62.13		62	
11	Pallati i Kongreseve	54.7	51	51.9	54.47	51.16	59.16		57.27	
12	Partizani i Panjohur	58.8	57.5	57.8	57.34	59.49	53.67		55.54	
13	Kryqëzimi te Selvia	56.6	55.7	57.3	58.72	58.34	51.71		52.27	
14	Rruga e Elbasanit	65	64.6	60.5	61.43	57	55.99		57.34	
15	Sheshi Skënderbe	60.6	60.7	60.2	62.49	58.48	55.06		58.67	
Niveli mesatar sipas stacioneve të monitorimit			59.3	57.3	57.82	56.21	56.12	57.94	57.49	56

(Përpunimi nga autorët, bazuar në RGJM)


Siç duket nga tabelat 1 dhe 2, në Raportet e Gjendjes në Mjedis të publikuara për vitet 2018 dhe 2020 mungojnë vlerat e regjistruara për secilën nga pikat e monitorimit, ndërsa është publikuar vetëm një vlerë mesatare për gjithë qytetin e Tiranës. Po ashtu, edhe në publikimet e viteve 2011-2019 vihet re paraqitja e një vlere mesatare vjetore për gjithë qytetin e Tiranës. Mesatarja aritmetike në të tilla raporte vlerësuese është një llogaritje e pakuptimtë dhe nuk është indikator i nivelit të zhurmave, e aq më pak tregues, mbi të cilin duhet të hartohen plane veprimi.

Zhurma e trafikut është e ndryshueshme dhe si e tillë, indikatorët e përdorur për vlerësimin e saj në raporte të ndryshme nuk mund të krahasohen me vlerat diskrete të referencave të OBSH. Në BE dhe kudo në vendet e zhvilluara ka standarde, që kërkojnë vlerësim parametrash të rinj, të cilët krahasohen me nivelet kufi sipas vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të pasqyruar edhe në kuadrin ligjor për zhurmat në vendin tonë.


Këto indikatorë statistikë, të cilët nuk janë të pasqyruar në kuadrin ligjor e aq më pak në praktikë, japin një vlerësim integral dhe më përfaqësues të nivelit të zhurmave, e rrjedhimisht, ekspozimit të publikut dhe, sigurisht, orientojnë politika dhe veprime më racionale në reduktimin e zhurmave mjedisore.

Në vijim janë paraqitur grafikisht vlerat e LAeq për intervalet e ditës dhe të natës, për secilin nga 15 stacionet e monitorimit në Bashkinë Tiranë, gjatë viteve 2007-2020.

Shqyrtimi i të dhënave në vite në 15 stacione monitorimi (përgjithësisht zona me trafik relativisht të rënduar) tregon qartë për tejkalim të normave si ditën, ashtu edhe natën. Si kudo, edhe në Tiranë, trafiku rrugor është burimi kryesor i zhurmës urbane. Edhe pse ka patur një rritje progresive të numrit të mjeteve në lëvizje nuk ka ndryshime esenciale të niveleve të zhurmave mjedisore, madje në disa raste edhe ulje në vlerat e ekspozuara.



Grafiku 1: Vlerat e Laeq-Ditë, për secilin nga Stacionet e monitorimit në vitet 2007-2020



Grafiku 2: Vlerat e Laeq-Natë, për secilin nga Stacionet e monitorimit në vitet 2007-2020




Figura 3: Harta e stacioneve të monitorimit të zhurmës në qytetin e Tiranës (Burimi: RGJM, 2018)




Figura 4: Hartë e niveleve të monitoruar të zhurmës në qytetin e Tiranës. (Burimi: RGJM 2018)

Figura e mëposhtme pasqyron nivelin e zhurmave të shkaktuar nga transportit rrugor ku matjet janë kryer gjatë ditës në vitin 2014 nga AKM.



Figura 5: Niveli i zhurmave nga trafiku rrugor (AKM 2014).

4. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I BURIMEVE QË GJENEROJNË ZHURMË DHE SHKAKTOJNË NDOTJE AKUSTIKE

Kompleksi urban i tingujve, i cili përfaqëson tërësinë e zhurmës në mjedisin urban, formohet nga një gamë e gjerë aktiviteteve ekonomike dhe sociale.

Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor

Identifikimi i aktiviteteve dhe përqendrimit të tyre në territorin e Bashkisë

Siç është treguar që në hyrjen e Planit, sektori i transportit përfaqëson burimin kryesor dhe më të madh të zhurmës në mjedis. I dyti pas tij, me një problematikë të njohur në drejtim të shqetësimit nga gjenerimi i zhurmave është Sektori i shërbimeve publike sociale dhe kulturore ku përfshihen:

- Bare, Kafene dhe Restorante (përfshirë lokale që orgaizojnë dasma dhe ceremoni të tjera familjare);
- Disko ose klube nate;
- Reparte shërbimesh të ndryshme si: ofiçina të riparimit të automjeteve, gomisteri, punime druri, punime duaralumini etj.

Kjo vjen për arsye të vetë vendndodhjes së tyre brenda blloqeve të banimit, si dhe të kohëzgjatjes së zhurmave që ato gjenerojnë. Këto aktivitete në pjesën më të madhe të tyre liçencohen nga njësitë e qeverisjes vendore dhe në kushtet e liçencimit nuk ka kërkesa specifike për nivelin e lejuar të zhurmave që ato duhet të respektojnë.

Kërkesa për pajisje me leje mjedisi parashikon vetëm ligji për administrimin mjedisor të zhurmave. Edhe pse ligji ka hyrë në fuqi ende nuk ka filluar procesi i liçencimit të këtyre aktiviteteve. Ligji parashikon jo vetëm nivelet e lejuara të zhurmave, por edhe oraret e lejuara.

Këto aktivitete në pjesën më të madhe të tyre liçencohen nga Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, përkatësisht aktivitete që kërkojnë leje të tipit C dhe në kushtet e liçencimit nuk ka kërkesa specifike për nivelin e lejuar të zhurmave që ato duhet të respektojnë.



Figura 6: Gomisteri (majtas) dhe servis motorçikletash (djathtas) në blloqet e banimit në rrugën Mine Peza.

Të dy subjektet operojnë jashtë kushteve teknike sepse shërbimet kryhen në mjedis të hapur, ndonëse edhe mjediset e brendshme nuk kanë izolim akustik.



Figura 7: Bar kafe në objekt banimi me aktivitet të lartë zhurmash deri në orët e vona të mbrëmjes.

Vlerësim i popullsisë së ndikuar prej tyre

Popullsia më e ndikuar nga këto lloj aktivitetesh është ajo banuese në zonën urbane të Bashkisë Tiranë që nënkupton kryesisht qytetin e Tiranës. Njësitë e shërbimit si bare, restorante apo lokale të çdo lloji, jo vetëm që janë në pjesën dërrmuese në katet e para të godinave të banimit, qofshin këto zona elitare ose jo, por në komplekset e reja gjenden disa pranë e pranë. Pak a shumë e njëjta situatë është edhe me vendndodhjen e objekteve të shërbimeve ekonomike të tilla si: servise automjetesh, gomisteri, lavazhe, punime druri dhe metali. Sa i takon njësive me karakter rural, ky lloj shqetësimi është më i ulët, pasi objekte shërbimesh të këtij lloji gjenden kryesisht përgjatë rrugëve (për arsye aksesi), jo pranë banesave. Për rrjedhojë, edhe masat prioritare duhet të fokusohen në njësitë urbane dhe me përqëndrim të lartë popullsie.

Tabela 4: Njësitë dhe popullsia më e ekspozuar ndaj zhurmës së objekteve të shërbimeve sociale dhe kulturore

Njësia	Sipërfaqja, km ²	Popullsia 2019
Njësia 1	3.06	51,871
Njësia 2	9.58	82,972
Njësia 3	2.01	45,174
Njësia 4	4.92	65,357
Njësia 5	2.87	86,997
Njësia 6	5.48	74,923
Njësia 7	3.06	74,950
Njësia 8	1.95	41,670
Njësia 9	2.82	64,014
Njësia 10	0.77	27,783
Njësia 11	5.21	65,354
Lagjia 14		25,278
	Total	706,343

Burimi: <https://opendata.tirana.al>

Vlerësimi i kushteve specifike të liçencimit dhe kontrolli i zbatimit të kërkesave ligjore në lidhje me menaxhimin e zhurmës në mjedis

Vendimi 587 i Këshillit të Ministrave, neni 3, përcakton orarin dhe nivelin e lejuar të zhurmave të lokaleve në qytet. Kështu, për lokalet e hapura, ditën e premte dhe të shtunë, zhurma e lejuar është e përcaktuar sipas standardeve të pranueshme dhe mund të aplikohet nga ora 19.00-24.00. Ndërsa për ditët e zakonshme të javës orari i lejuar është 19.00-

Ndërsa ambjentet e mbyllura nuk kanë kufizim të orarit, por duhet të respektojnë nivelin e lejuar të zhurmës në mënyrë që të mos shkaktojnë shqetësim në komunitet.

Sektori i transportit

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e ka klasifikuar zhurmën e trafikut, duke përfshirë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, si shkaktarin e dytë më të rëndësishëm të shëndetit të keq në Evropën Perëndimore, pas ndotjes së ajrit të shkaktuar nga grimcat shumë të imta, ndërkohë bazuar në statistika dhe informacione ekzistuese, trafiku rrugor është burimi më i madh i ndotjes nga zhurma dhe llogaritet që shkakton 78% bezdisje në popullatë.

Identifikimi i mjeteve dhe aktiviteteve të transportit, si dhe numrit të mjeteve që qarkullojnë në territorin e Bashkisë Tiranë



Figura 8: Qarkullimi intensiv i mjeteve në rugën Mine Peza (shumë banesa përgjatë rrugës pa izolim akustik).

Në vendin tonë shkaktari kryesor i emetimit të zhurmave është trafiku rrugor. Kjo sepse sistemi hekurudhor pothuajse nuk ekziston, ndërsa sa lidhet me transportin ajror ne kemi vetëm një aeroport ndërkombëtar. Thënë ndryshe, është zhurma e rrugës (d.m.th. trotuarit), e lidhur kryesisht me trafikun e automjeteve, një nga më të përhapurat dhe më pak të studiuara. Zhurma e rrugës është e vështirë të injorohet dhe e vështirë të largohesh prej saj. Kjo zhurmë është gjithashtu potencialisht e rrezikshme, pasi zhurma e tepërt nga çdo burim është një faktor i rëndësishëm rreziku për efektet e dëmshme shëndetësore. Ekspozimi ndaj zhurmës së rrugës është një burim potencialisht i rëndësishëm i ekspozimit të përgjithshëm të zhurmës, dhe zvogëlimi i burimeve të zhurmës së tepërt në rrugë duhet të jetë një përparësi për shëndetin publik dhe planifikimin urban.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) administron bazën e të dhënave për të gjitha automjetet e regjistruara dhe që qarkullojnë në Shqipëri. Sipas të dhënave zyrtare, në fund të qershorit 2019 numri i përgjithshëm i flotës ishte rreth 630000 automjete, **me 29% (179, 167) të regjistruar në Bashkinë e Tiranës. Rreth 78% e flotës së regjistruar të automjeteve në Tiranë përbëhet nga automjete individuale.**



Figura 9: Mjete bujqësore që qarkullojnë në zonat qendrore të Tiranës.

Identifikimi i orëve të pikut dhe zonave problematike

Të gjitha rrugët e transportit dhe qarkullimit të autgjeteve janë korridore të gjenerimit të zhurmës nga lëvizja e automjeteve. Në gjenerimin e zhurmës në këto akse rrugore ndikojnë disa faktorë, të tillë si: përqëndrimi i automjeteve në njësinë e kohës për kilometër, ritmet e qarkullimit, dhe tipi i shtresës së rruges (sa më e ashpër shtresa aq më i madh fërkimi dhe rrjedhimisht niveli i zhurmës). Po ashtu dhe përdorimi pa kriter i borive përbën një burim tjetër zhurme në këto akse rrugore. Ndikimi i zhurmës nga transporti është një ndër elementet kryesore dhe të përhapura pothuaj në të gjithë hapësirën e Tiranës urbane (qytet) dhe rrethinave të saj. Mungesa e barrierave zhurmëkapëse dhe mungesa e izolimit akustik të pallateve e godinave (veçanërisht atyre në frontin e parë, pra në kontakt direkt me aksin rrugor) rezultojnë në nivele të konsiderueshme të zhurmave në mjediset e banuara në qytet.

Tabela 5: Itineraret e transportit dhe oraret përkatëse

	Zona me ngarkesë dhe densitet të lartë ekspozimi	Oraret më të ngarkuara
1	Segmenti Qendër – Pallati me Shigjeta	7 am – 9pm
2	Unaza e Vogël në tërë perimetrin e saj	7 am – 9pm
3	Unaza e dytë (tradicionale) e Tiranës	7 am – 9pm
4	Segmenti i aksit nga Ura e Vasil Shantos tek nënkalimi i doganës	7 am – 9pm
5	Segmenti Qendër – rruga Mine Peza – Laprakë	7 am – 9pm
6	Segmenti Kinostudio – Kombinat	7 am – 9pm
7	Segmenti Unazë – rruga M.Shyri – Bashkia Tiranë – 9 Katëshet	7 am – 9pm
8	Qendër – rruga e Kavajës – 21 Dhjetori – Kombinat	7 am – 9pm
9	Segmenti nga Bërryli në Uzinën e Autotraktorëve	7 am – 9pm
10	Segmenti Liceu Artistik – 9 katëshet	7 am – 9pm

Vlerësim i popullatës së ndikuar nga zhurmat e gjeneruar nga sektori i transportit.

Në tërësi e gjithë popullsia e Bashkisë Tiranë është nën ndikimin negativ të zhurmës, megjithatë njësitë rurale të saj Dajti, Farka, Vaqarri, Peza, Ndroqi, Baldushku etj. janë më pak të ekspozuara dhe vlerësohet se nuk janë nën ndikimin kritik të zhurmës.

Zonat dhe popullsia më e ekspozuar e Bashkisë Tiranë që përfshihen si zonë e parë kritike gjenden përgjatë korridoreve të akseve rrugore të Unazës së vogël dhe asaj tradicionale, po ashtu dhe përgjatë akseve që ndërpriten dhe ndërliken me këto 2 unaza. Dendësia e

rjetit rrugor dhe popullsisë së ekspozuar janë faktorët kryesorë që përbëjnë dhe zonën më të ekspozuar ndaj zhurmave të transportit në Bashkinë Tiranë. Rrjedhimisht në territorin e Bashkisë Tiranë, njësitë administrative me të ekspozuara ndaj zhurmës rezultojnë: Njësia 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 13 (zona e Kasharit- Astirit). Në këto zona rezulton një popullsi e ekspozuar totale prej 706343 banorë.

Tabela 6: Njësitë dhe popullsia më e ekspozuar ndaj zhurmës së transportit.

Njësia*	Sipërfaqja, km ²	Popullsia 2019
Njësia 1	3.06	51,871
Njësia 2	9.58	82,972
Njësia 3	2.01	45,174
Njësia 4	4.92	65,357
Njësia 5	2.87	86,997
Njësia 6	5.48	74,923
Njësia 7	3.06	74,950
Njësia 8	1.95	41,670
Njësia 9	2.82	64,014
Njësia 10	0.77	27,783
Njësia 11	5.21	65,354
Baldushk	112.88	5,375
Bërzhitë	72.47	5,874
Dajt	94.64	24,267
Farkë	27.49	21,860
Kashar	39.08	47,476
Ndroq	63.31	9,788
Petrelë	67.26	6,819
Pezë	108.25	5,924
Shëngjergj	206.34	2,567
Vaqarr	46.69	10,472
Zall Bastar	153.97	5,266
Zall Herr	58.29	12,212
Kërrabë	18.63	3,054
Lagjja12		13,288
Lagjja13		9,423
Lagjja14		25,278

* Popullsia e lagjeve 12, 13, 14 është përfshirë edhe tek njësitë administrative Dajt, Farkë dhe Kashar.
Burimi: <https://opendata.tirana.al>





Figura 10: Njësiti administrative më të ekspozuara ndaj zhurmës së transportit në Bashkinë Tiranë.



Grafiku 3: Njësiti administrative më të ekspozuara ndaj zhurmës së transportit në qytetin e Tiranës.

Vlerësimi i sinjalistikës ekzistuese dhe elementeve të integruarane të në lidhje me ndalimin dhe reduktimin e zhurmës në mjedis

Menaxhimi dhe reduktimi i zhurmës nga mjetet dhe aktiviteti i transportit rrugor paraqet vështirësi të vazhdueshme dhe të mëdha. Kjo lidhet së pari me vetë gjendjen e planifikimit urban, por dhe me përdorimin intensiv të automjeteve personale. Përveç sa më sipër, për të reduktuar zhurmën nevojiten politika dhe investime të konsiderueshme, si në sektorin publik ashtu dhe nga vetë qytetarët (izolimi akustik i banesave të vjetra, përdorimi i transportit alternativ

pa zhurmë etj). Nga kjo pikëpamje kërkohet një angazhim i përbashkët dhe i qëndrueshëm duke u mbështetur me investime dhe politika që reduktojnë transportin me mjete motorike zhurmuese dhe e zëvendësojnë me ato më të qeta (mjete elektrike) etj. Një shqetësim i pranishëm zhurmues që lidhet me fluksin e trafikut është dhe përdorimi pa kriter i borive nga shoferët dhe përdorimi i tubave të modifikuara të shkarkimit (marmida), të cilat zhurmojnë jashtë normave dhe standardeve të prodhimit teknik të mjeteve (makina dhe motorçikleta).

Nisur nga kjo, duhet që të plotësohet sinjalistika rrugore me kufizimet dhe ndalimet në përdorimin e borive, por, njëkohësisht dhe me informimin për kufizimet e shpejtësisë së lejuar në qendrat urbane. Në shumë akse urbane (brenda njësive të treguara më lart) drejtuesit e mjeteve ngasin me shpejtësi mbi normat e lejuara, duke bërë që të rritet forca e fërkimit me asfaltin, veprim që shoqërohet me nivele më të larta zhurmash.




Figura 11: Nivelet e zhurmës së gjeneruar nga tipe të ndryshme automjetesh në varësi të nivelit të shpejtësisë. Burimi: Sandberg 2003

Reduktimi i kufijve të shpejtësisë është mënyra më e shpejtë, më e lirë dhe më e barabartë për të zvogëluar zhurmën e trafikut. Ngadalë është më e qetë. Ulja e kufijve të shpejtësisë nga 50 km/h në 30 km/h do të zvogëlonte zhurmën e trafikut me rreth 3dB (A).

Drejtuesi i mjetit duhet të rregullojë shpejtësinë e mjetit në mënyrë që të mënjanojë çdo rrezik për sigurinë e njerëzve dhe mallrave dhe çdo çrregullim tjetër të mundshëm në trafik. Shpejtësia duhet të jetë në përputhje me karakteristikat, gjendjen, ngarkesën e mjetit, si dhe karakteristikat dhe gjendjen e rrugës, trafikun, etj. Gjendja teknike e mjetit duhet të jetë e tillë që të përballojë të gjitha manovrat e nevojshme në kushte të sigurta.

Neni 140 - Kufizimet e shpejtësisë²¹

Entet pronare të rrugëve kanë për detyrë të rivendosin menjëherë kufijtë e shpejtësisë, në rast se bien shkaqet që kanë detyruar vendosjen e kufijve të veçantë. Kategoritë vijuese të mjeteve nuk mund t'i kalojnë shpejtësitë e poshtëtreguara:

- a) ciklomotori: 30 km/orë
- b) automjete ose motomjete që përdoren për transportin e mallrave të rrezikshme, kur udhëtojnë të ngarkuara: 50 km/orë jashtë qendrave të banuara; 30 km/orë brenda qendrave të banuara;
- c) makina bujqësore dhe makina teknologjike: jashtë qendrave të banuara 40 km/orë dhe 20 km/orë brenda qendrave të banuara, kur kanë rrota pneumatike ose sisteme të tjera të barasvlefshme; 15 km/orë në gjithë rastet e tjera;
- d) autokarro: 60 km/orë jashtë qendrave të banuara dhe 30 km/orë në qendrat e banuara;
- e) autotrena të përbërë nga një automjet dhe nga një rimorkio sipas shkronjave "h", "i" dhe "l" të nenit 54, pika 1: 70 km/orë jashtë qendrave të banuara; 35 km/orë në qendrat e banuara; 80 km orë në autostradë.
- f) autobusë dhe trolejbusë me peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë më të madhe se 8 tonë: 70 km/orë jashtë qendrave të banuara, 35 km/orë në qendrat e banuara, 90 km/orë në autostradë;
- g) automjete të destinuara për transportin e mallrave ose për përdorime të tjera, me peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë më të madhe se 3.5 tonë dhe deri në 12 tonë: 70 km/orë jashtë qendrave të banuara; 90 km/orë në autostradë;
- h) automjete të destinuara për transportin e mallrave ose për përdorime të tjera, me peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë më të madhe se 12 tonë: 60 km/orë jashtë qendrave të banuara; 80 km/orë në autostradë;
- i) kamionë me peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë më të madhe se 5 tonë që përdoren për transportin e njerëzve (sipas nenit 81, pika 6): 70 km/orë jashtë qendrave të banuara; 80 km/orë në autostradë;
- j) makina ngarkim-transporti kur udhëtojnë me ngarkesë të plotë: 30 km/orë në qendrat e banuara; 60 km/orë jashtë qendrave të banuara.

Në kuadër të këtij plani u kryen vrojtime në disa nga akset rrugore me ekspozim të lartë zhurmash si pasojë e qarkullimit të automjeteve. Çdo ditë qytetarët e Tiranës përballen me zhurmën e borive të makinave, ndonëse në zona urbane është i ndaluar, asnjë drejtues automjetesh nuk e zbaton këtë rregull. Kryesisht përdorimi i borive nga ana e shoferëve është i shtuar në zonat ku ka më shumë lëvizje automjetesh, në semafor apo ku ka trafik.

Identifikimi dhe vlerësimi i objekteve të rëndësisë dhe karakterit të veçantë si institucione, shkolla, spitale etj. të ekspozuara ndaj zhurmës së krijuar nga sektori i transportit

Bazuar në të dhënat e siguruar nga Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, QZHEF, në 11 njësitë administrative urbane të Tiranës ndodhen 34 çerdhe. Referuar Drejtorisë së Politikave Lokale Arsimore e Shëndetësore në Bashkinë e Tiranës, gjatë vitit 2018-2019 numri i kopshteve publike në Tiranë ishte 118 kopshte në të 24 njësitë administrative të Tiranës. Rekomandime për izolimin akustik të këtyre objekteve janë dhënë në matricën e masave në këtë Plan.

²¹ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë

Pajisjet dhe makineritë që gjenerojnë zhurmë

Identifikimi i pajisjeve dhe makinerive që gjenerojnë zhurmë dhe si ndikojnë ato në popullatë

Shërbimet e ndryshme sociale dhe ekonomike përdorin pajisje dhe makineri që çlirojnë zhurmë në nivele të ndryshme. Disa nga këto pajisje mund të çlirojnë zhurmë për periudha të gjata kohore (aspiratorët etj.), ndërkohë që ato përdoren në mënyrë individuale ose disa bashkë (në kantieret e ndërtimit). Pajisjet dhe makineritë që gjenerojnë zhurmë në mjedis përfshijnë:

- Gjeneratorët elektrikë
- Aspiratorët e lokaleve (restoranteve, shërbimeve sociale)
- Kompresorë me ajër (gomisteritë etj)
- Pompat e ujit (me kapacitete industriale) në objekte në qendrat urbane të banurara
- Çekiçët pneumatikë, eskavatorët, vinçat, pompat (kantieret e ndërtimit)
- Çekiçët pneumatikë, trapanot dhe mjetet manuale ndërtimore (në rikonstruksionet e banesave)
- Pompat e larjes së automjeteve
- Sharrat për prerjen e betonit dhe drurit

Tabela 7: Nivelet mesatare të zhurmës së gjeneruara nga makineritë që operojnë në mjedis të hapur.

Pajisje tipike ndërtimi	Mesatarja e nivelit tipik të zhurmës së gjeneruar (dB)
Asfaltuesit	101
Rula ngjeshës	90
Eskavatorë	87
Nivelues	<85
Buldozerë	96
Kamionë të rëndë	86
Piruna	89
Matrapikë	100
Vinça	100
Sharra	88
Autobote uji	71
Gjeneratorë	<85

Burimi: Bordi i kompensimit të punëtorëve të British Columbia, 2000
(BS 5228: 1997 Kontrolli i zhurmës dhe dridhjeve në ndërtime dhe faqet e hapura)



Figura 12: Gjeneratori dhe aspiratori i një subjekti shërbimi.

Identifikimi i grupeve të popullsisë dhe institucioneve të veçantë të ekspozuar ndaj tyre

Këto burime zhurmash janë të pranishme në të gjitha zonat urbane, megjithatë më të përqendruara në zonat e qytetit të Tiranës urbane dhe më pak në njësitë me karakter rural të saj si Peza, Dajti, Krraba etj. Nga kjo rrethanë dhe masat prioritare duhet të fokusohen në njësitë urbane dhe me përqendrim të lartë populsie.

Tabela 8: Njësitë dhe popullsia më e ekspozuar ndaj zhurmës së pajisjeve dhe makinerive

Njësia	Sipërfaqja, km ²	Popullsia 2019
Njësia 1	3.06	51,871
Njësia 2	9.58	82,972
Njësia 3	2.01	45,174
Njësia 4	4.92	65,357
Njësia 5	2.87	86,997
Njësia 6	5.48	74,923
Njësia 7	3.06	74,950
Njësia 8	1.95	41,670
Njësia 9	2.82	64,014
Njësia 10	0.77	27,783
Njësia 11	5.21	65,354
Lagjja 14		25,278
	Total	706,343

Burimi: <https://opendata.tirana.al>

Vlerësimi i kushteve specifike të liçencimit dhe kontrolli i zbatimit të kërkesave ligjore në lidhje me menaxhimin e zhurmës në mjedis. Mundësia e eliminimit dhe ose shmangies

Makineritë dhe pajisjet teknologjike që çlirojnë zhurmë në mjedis janë të pranishme dhe domosdoshme për veprimtarite sociale dhe ekonomike. Menaxhimi i zhurmës që ato çlirojnë, ngelet përherë një sfidë e vetë subjekteve që çlirojnë zhurmë, por dhe autoriteteve ligjzbatuese dhe, së pari e qeverisjes vendore.

Praktika aktuale e liçencimit për kufizimin e zhurmës

Rregjimi aktual i licencimit të aktiviteteve në bashki nuk përfshin rregullimin apo vendosjen e kushteve kufizuese për zhurmën e lejuar nga aktivitetet sociale dhe ekonomike me karakter urban. Aktualisht aktivitetet që çlirojnë zhurmë (gomisteri, bare e klube, autoservise, furra bukë etj.) nuk rregullohen me asnjë lloj leje, leja është instrumenti i parë në parandalimin e krijimit të zhurmave, por dhe instrumenti që përmban kufizimet e duhura dhe mundëson forcimin e ligjit nga organet inspektuese. Pra në të gjithë vendin, sot nuk ka një rregjim licencues rregullator për këto aktivitete duke bërë të vështirë deri të pamundur zgjidhjen e një ankese sado të thjeshtë të komunitetit për zhurmat urbane të këtyre aktiviteteve.

Për të avancuar më tej për zgjidhjen e këtij problemi dhe për të mundësuar krijimin e kapaciteteve për menaxhimin e mjedisit në nivel vendor është e nevojshme që të zgjerohen disa kompetenca, të cilat nuk mund të ushtrohen në praktikë nga agjencitë e qeverisjes qendrore. Është e pamundur që një numër tepër i kufizuar i stafit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të mbulojë e adresojë shqetësimet e përditëshme për zhurmat në 61 bashkitë e vendit, kjo është tashmë e vërtetuar nga praktika për më tepër se 15 vjet.

Disa rekomandime kryesore për të zgjidhur këtë çështje dhe ngërç ligjor e praktik janë përfshirë në Shtojcën I dhe II të këtij Plani.

5. SHKALLA E NDIKIMIT TË SECILIT BURIM NË NDOTJEN AKUSTIKE

Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor

Aktivitetet e shërbimeve (baret në veçanti, gomisteritë, lavazhet) në zonat urbane me përqëndrime të larta popullore përbëjnë një ndër burimet kryesore të zhurmës. Këtyre u shtohen dhe kantieret e ndërtimit përfshirë ndërtimet e reja ose ato të ristrukturimeve të infrastrukturës. Për detaje referoju seksionit 4, mësipër.

Sektori i transportit

Sektori i transportit ka shkallën më të lartë të ndikimit për shkak dhe të niveleve të larta dhe vazhdueshme të zhurmës, si dhe praninë dhe shtrirjen e rrugëve në të gjitha nivelet e tyre. Tirana urbane është dhe më e ekspozuara në terma të nivelit të zhurmës dhe popullsisë të ekspozuara nga sektori i transportit. Sektori i transportit dhe numri i madh i automjeteve që qarkullojnë në Tiranë sidomos atë urban është burimi më i madh dhe kryesor i zhurmave në qytet, sidomos gjatë orëve të mëngjesit deri vonë në mbrëmje. Për detaje referoju seksionit 4, mësipër.

Pajisjet dhe makineritë që gjenerojnë zhurmë

Ndikimi i këtij sektori është i lidhur me atë të sektorit të shërbimeve sociale dhe ekonomike dhe përqëndrimin e tyre. Nga kjo pikëpamje shkalla e ndikimit në ndotjen akustike reflekton dy faktorë kryesorë; natyrën e aktiviteteve ekonomike dhe përqëndrimin e popullsisë së ekspozuar. Për detaje referoju seksionit 4, mësipër.

6. MASAT E PROPOZUARA PËR REDUKTIMIN APO ELEMENIMIN E ZHURMAVE NË MJEDIS DHE ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË PLANIT

Masat e propozuara adresojnë veprime prioritare që duhen zbatuar për të ndërtuar një sistem funksional të menaxhimit të zhurmës nga Bashkia Tiranë. Ato synojnë të përmbushin paralel tri qëllime:

- ndërtimin e kapaciteteve institucionale të Bashkisë për menaxhimin e zhurmës;
- ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore
- forcimin e rregullave dhe kriterëve në praktikë duke avancuar me procesin e menaxhimit të zhurmave duke u fokusuar në burimet e zhurmës prioritare.

Plani dhe masat duhet të monitorohen, raportohen çdo vit dhe përditësohen sipas nevojës në çdo 2 vjet.

Tabela 9: Njësitë administrative prioritare për masat e kontrollit ndaj zhurmës

Njësia	Sipërfaqja, km ²	Popullsia 2019
Njësia 1	3.06	51,871
Njësia 2	9.58	82,972
Njësia 3	2.01	45,174
Njësia 4	4.92	65,357
Njësia 5	2.87	86,997
Njësia 6	5.48	74,923
Njësia 7	3.06	74,950
Njësia 8	1.95	41,670
Njësia 9	2.82	64,014
Njësia 10	0.77	27,783
Njësia 11	5.21	65,354
Lagjja14		25,278
	Total	706,343

Burimi: <https://opendata.tirana.al>

Tabela 10: Matrica e masave për kontrollin dhe menaxhimin e zhurmës në territorin e Bashkisë Tiranë

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Roli/përgjegjësia	Struktura mbështetëse	Afati	Mënyra e verifikimit	Struktura monitoruese
1	Fuqizimi institucional i Bashkisë Tiranë për menaxhimin e zhurmave (FI)	FI -1	Rekrutimi i specialistëve (me diplome në fizike) për suport teknik në menaxhimin e zhurmës	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerezore	Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar	2022-2023	Rekrutimi i specialistëve	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FI-2	Hartimi i listës së aktiviteteve prioritare që gjenerojnë zhurmë dhe hartimi i regjistrit elektronik të veprimtarive me zhurmë (përditesim nga sektorët përkatës), dhe hartimi i tyre (vendodhja) në çdo njësi administrative prioritare. Regjistri të përditesohet vazhdimisht në bazë të statusit të veprimtarive (shtim ose mbyllje).	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ dhe Sektori i kontrollit të ndotjeve në mjedis AMK	Drejtoria e Monitorimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Administrimit të NjA	2023	Egzistenca e regjistrit	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FI-3	Regjistër mbi vlerësimin e situatës (aktiviteteve prioritare sipas FI-2) në terren mbi bazë njësie administrative duke kryer një vlerësim me një format të miratuar paraprakisht të aktiviteteve prioritare për zhurmat.	Sektori i kontrollit të ndotjeve në mjedis AMK	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Drejtoria e Licensimit dhe Gjendjes Civile Drejtoria e Administrimit të NjA	2023-2024	Raport vlerësimi për çdo njësi	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FI-4	Të kërkohet ndryshimi i kuadrit ligjor rregullator për rikthimin e "Pajisjes me Leje për Kontrollin e zhurmave" për aktivitetet që emetojnë zhurmë në mjedis. Integrimi i kushteve për zhurmat në kuadrin e licensimit aktual në Bashki, aneks i detyrueshëm i licensimit. Të përcaktohen rregulla e kritere për aktivitetet që emetojnë zhurmë përfshirë dhe kriteret e licensimit të tyre.	Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Sektori i kontrollit të ndotjeve në mjedis AMK	Drejtoria e Planifikimit të Territorit Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	2022	Licensat mbas Shtatorit 2022 me kushte kufizuese për zhurmat	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ

Nr	Objektivi prioritar	Masat prioritare	Roli/përgjegjësia	Struktura mbështetëse	Afati	Mënyra e verifikimit	Struktura monitoruese	
		FI-5	Hartimi i rregullores për kontrollin e zhurmave në kantieret e punimit dhe në objektet e veprimarive ekonomike në Bashkinë Tiranë.	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit Drejtorja e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit	2023	Rregullorja emiratuar	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FI-6	Sigurimi imjeteve të nevojshme për aparate për matjen e zhurmave për të bërë verifikimet paraprake gjatë licensimit por dhe kontrollit prej sektorit të Bashkisë	Sektori i kontrollit të ndotjeve në mjedis AMK Drejtorja e përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ		2023	Aparatet	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FI-7	Hartimi dhe funksionimi i mekanizmit të trajtimit të ankesave për zhurmat. Mekanizmi duhet të promovohet nëpërmjet afisheve në këndet e informimit në cdo pallat, faqeve të Bashkisë Tiranë (rrjete sociale dhe weBSITE).	Drejtorja e përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Sporteli i Drejtorisë së Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët së bashku me Numrin e Gjelbër Drejtorja e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit	2023 dhe ne vazhdim	Mekanizmi i hartuar dhe publikuar	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FI-8	Trajnime të posatshme të stafit të Bashkisë me rol dhe përgjegjësi në kontrollin e zhurmës ²² .	Drejtorja e Burimeve Njerezore dhe Trajnim Zhvillimit	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ Sektori i kontrollit të ndotjeve në mjedis AMK	2023-vazhdim	Realizimi i trajnimit	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FI-9	Hartëzimi i zhurmave për Qytetin e Tiranës	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja Juridike, Drejtorja e Planifikimit të Territorit	2023	Hartëzimi i Zhurmave për Qytetin	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ

²² Trajnimi mund të bëhet me asistencë teknike nga donatore të huaja ose nëpërmjet prokurimit të asistencës nga subjekte private të specializuara.

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Roli/përgjegjësia	Struktura mbështetëse	Afati	Mënyra e verifikimit	Struktura monitoruese
		FI-10	Shpallja e zonave të qeta ne Qytetin e Tiranës, me kufizime për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.	Drejtoria e Planifikimit te Territorit	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor	2023	Zonat e Shpallura	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
2	Permiresimi i infrastruktures per reduktimin e zhurmave (PI)	PI -1	Identifikimi dhe rregjistrimi i objekteve sociale e kulturore që administrohen nga Bashkia Tiranë (cerdhe, kopshte, shkolla, qendra sociale, biblioteka) që kanë nevojë për izolim akustik.	Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Vazhdimisht	Raport perkates	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		PI-2	Investime në objekte publike dhe në banesa private të ekspozuara ndaj zhurmës (izolim akustik dhe termik nga fondi social). Vlerësimi i nevojave dhe ndërhyrjeve të bëhet nga sektori perkates në Bashki.	Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike	Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike	Vazhdimisht	Raport investimesh	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
	Vleresimi i ndotjes akustike nga punet publike. P.SH, Unaza, autostrada etj.	PI-3	Plotesimi i rrugëve bashkiake me sinjalistikë për kufizimet e shpejtesisë nga sektori perkates i infrastrukturës në Bashki.	Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor	Drejtoria e Planifikimit te Territorit dhe Drejtoria e përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Vazhdimisht	Raport perkates	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
3	Forcimi i ligjit dhe masave per kontrollin e zhurmes	FL-1	Informimi i bizneseve dhe distributorëve me motorcikleta të zëvendësojnë motorcikletat ne mjete me zhurme te ulët ose motorra me bateri.	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ Drejtoria e Transportit e Trafikut	Sektori i kontrollit te ndotjeve ne mjedis AMK	Vazhdimisht	Raport perkates	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FL-2	Këshillimi dhe penalizimi nga Policia Bashkiake në rast të rënies së borisë (pa shkak, në trafik) në zonat e banuara.	Policia Bashkiake	Sektori i kontrollit të ndotjeve ne mjedis AMK Drejtoria e përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	2023 Vazhdim	Rapote perkatese	Drejtoria e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Roli/përgjegjësia	Struktura mbështetëse	Afati	Mënyra e verifikimit	Struktura monitoruese
		FL-3	Njoftimi i aktiviteteve me zhurmë (servise, gomisteri, bare, furra bukë etJ) të licensuara në Tiranë urbane (zonë prioritare sipas njësive mësiper) për oraret e punës lidhur me zhurmat, Ndalimet dhe penalitetet për shkeljet si dhe detyrimin për kontrollin e zhurmës dhe pajisjeve zhurmuese. Informimi aktiv i subjekteve që janë në listen e gjenerimit të zhurmave sipas FI-2 (shperndarësit e picave të marrin masa për motorcikletat zhurmese, riparime etj).	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Sektori i kontrolit të ndotjeve në mjedis AMK	2023 Vazhdimisht	Raporte perkatase	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FL-4	Rishikimi i licensave të dhena për shfrytëzim objekti në Qytetin e Tiranës (njesitë e qytetit) për aktivitetet me zhurmë dhe reflektimi i kushteve të nevojshme për kontrollin e zhurmës.	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja e Licensimit dhe Gjëndjes Civile	Vazhdimisht	Licensat e azhuruara	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		FL-5	Monitorim në mjedise të brendshme për nivelin e zhurmës dhe mbrojtjen e shëndetit publik nga këto zhurma (vecanerisht baret që përdorin muzikë në nivele tej normave të lejuara për zhurmat në mjedise të mbyllura).	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Policia Bashkiake	2023 Vazhdim	Raporte perkatase	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
4	Ndërgjegjesim, sensibilizim për zhurmat	NS-1	Afishimi i tabelave informuese dhe sensibilizuese për nivelin e zhurmave, ndalimin e borive në hapësirën urbane dhe paralajmëruese për penalitetet	Drejtorja e Transportit e Trafikut Rrugor	Sektori i Kontrollit të ndotjeve në Mjedis AMK, Drejtorja e Përgjithshme për Marrëdhënien me Publikun dhe Jashtë	Janar 2023 Dhjetor 2023-	Tabelat	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		NS-2	Fushata ndërgjegjesimi dhe informimi mbi ndotjen akustike Promovimi i masave për kontrollin e zhurmave në faqen elektronike të Bashkisë dhe në rrjetet sociale të Bashkisë	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja e Përgjithshme për Marrëdhënien me Publikun dhe Jashtë Drejtorja e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit	Vazhdimisht	Aktivitetet dhe realizimi i publikimeve	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Roli/përgjegjësia	Struktura mbështetëse	Afati	Mënyra e verifikimit	Struktura monitoruese
		NS-3	Fushate sensibilizuese në media (RTSH etj) dhe terren për kufizimin e zhurmave	Drejtorja e përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja e Medias dhe Komunikimit	vazhdimisht	Realizimi i fushatave dhe programeve	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		NS-4	Vendosja e një njoftimi nga administratorët në këndin e njoftimeve për rregullat për zhurmat në restaurimet e brendshme, ankesat etj.	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja e Administrimit të NjA	2023-vazhdimisht	Egzistenca e njoftimeve në cdo shkallë	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		NS-5	Edukimi dhe fushata ndërgjegjesimi për reduktimin e zhurmës.	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja e Përgjithshme për Marrëdhënie me Publikun dhe Jashtë	Vazhdimisht	Realizimi i fushatave	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
5	Raportimi, publikimi dhe bashkepunimi me OSHC dhe grupet e interesit (RP)	RP-1	Publikimi i informacionit grafik për nivelet e zhurmave në qytet (harte dhe grafike) në faqen elektronike të Bashkisë Tiranë.	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Drejtorja e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit	Sa here ka të dhëna	Informacioni i publikuar dhe perditësuar cdo vit	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		RP-2	Forcimi i bashkepunimit dhe bashkërendimi me shoqërinë civile dhe qytetarët për zbatimin e planit të veprimit të zhurmave.	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Sektori i Kontrollit të ndotjeve në Mjedis AMK	vazhdimisht	Raport për takimin	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ
		RP-3	Raportimi mbi ecurinë e zbatimit të planit.	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ	Sektori i Kontrollit të ndotjeve në Mjedis AMK	1 here në vit nisur nga 30 janari 2023	Raporti i hartuar dhe publikuar në faqen elektronike të Bashkisë	Drejtorja e Përgjithshme Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm DPMZHQ

7. PËRLLOGARITJA E KOSTOVE DHE PLANIFIKIMI I FONDEVE TË NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E PLVZHBT

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Kosto në LEK	Burimi i financimit
1	Fuqizimi institucional i Bashkise Tirane per menaxhimin e zhurmave (FI)		Rekrutimi i specialistëve (me diplome në fizike) për suport teknik në menaxhimin e zhurmës.	Buxheti i Bashkisë	Buxheti i Bashkisë
		FI-2	Hartimi i listes së aktiviteteve prioritare që gjenerojnë zhurmë dhe hartimi i regjistrit elektronik të veprimtarive me zhurmë (përditesim nga sektorët perkates), dhe hartëzimi i tyre (vendodhja) në cdo njesi administrative prioritare Rregjistri të përditesohet vazhdimisht në bazë të statusit të veprimtarive (shtim ose mbyllje).	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		FI-3	Regjister mbi vlerësimin e situates (aktiviteteve prioritare sipas FI-2) në terren mbi bazë njesie administrative duke kryer një vleresim me një format të miratuar paraprakisht të aktiviteteve prioritare për zhurmat.	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		FI-4	Të kërkohet ndryshimi i kuadrit ligjor rregullator për rikthimin e “Pajisjes me Leje për Kontrollin e zhurmave” për aktivitetet që emetojnë zhurmë në mjedis Integrimi i kushteve për zhurmat në kuadrin e licensimit aktual në Bashki, aneks i detyrueshëm i licensimit. Të perckatohen rregulla e kriteret për aktivitetet zhurmëse përfshire dhe kriteret e licensimit të tyre.	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		FI-5	Hartimi i rregullores për kontrollin e zhurmave në kantieret e punimit dhe në objektet e veprimtarive ekonomike në Bashkinë Tiranë.	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Kosto në LEK	Burimi i financimit
		FI-6	Sigurimi i aparateve (dore) për matjen e zhurmave për të bërë verifikimet paraprake gjatë licensimit por dhe kontrollit prej sektorit të Bashkisë.	Buxheti i Bashkise	Buxheti i Bashkisë
		FI-7	Hartimi dhe funksionimi i mekanizmit të trajtimit të aknesave për zhurmat Mekanizmi duhet të promovohet nëpërmjet afisheve në këndet e informimit në cdo pallat, faqeve të Bashkisë Tiranë (rrjete sociale dhe website).	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		FI-8	Trajnime të posatshme të stafit të Bashkisë me rol dhe përgjegjesi në kontrollin e zhurmes ²³ .	Mbuluar nga pagat e personelit.	Buxheti i Bashkisë
		FI-9	Hartëzimi i zhurmave per Qytetin e Tiranës (sipas udhezimit te 2013)	Do vlerësohet në një moment të dytë	Buxheti i Bashkise
		FI-10	Shpallja e zonave të qeta në Qytetin e Tiranës, me kufizime për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
2	Permiresimi i infrastruktures per reduktimin e zhurmave (PI)	PI -1	Identifikimi dhe rregjistrimi i objekteve sociale e kulturore që administrohen nga Bashkia Tiranë (cerdhe, kopshte, shkolla, qendra sociale, biblioteka) që kanë nevojë per izolim akustik.	Mbuluar nga pagat e personelit.	Buxheti i Bashkisë
		PI-2	Investime në objekte publike dhe në banesa private të ekspozuara ndaj zhurmës (izolim akustik dhe termik nga fondi social). Vlerësimi i nevojave dhe nderhyrjeve të bëhet nga sektori perkatës në Bashki.	Te panjohura aktualisht (do te percaktohen sipas nevojave).	Buxheti i Bashkisë
		PI-3	Plotësimi i rrugëve bashkiake me sinjalistikë për kufizimet e shpejtesisë nga sektori përkatës i infrastrukturës në Bashki.	Te panjohura aktualisht (do te percaktohen sipas nevojave).	Buxheti i Bashkisë

²³ Trajnimi mund te behet me asistence teknike nga donatore te huaj ose nepermjet prokurimit te asistences nga subjekte private te specializuara.

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Kosto në LEK	Burimi i financimit
3	Forcimi i ligjit dhe masave për kontrollin e zhurmës (FL)	FL-1	Informimi dhe bashkëpunimi me bizneset dhe distributorët me motorcikleta për të zëvendësuar motorcikletat në mjete pa zhurmë ose me motorra me bateri.	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		FL-2	Këshillimi dhe penalizimi nga Policia Bashkiake në rast të rënies së borisë (pa shkak, në trafik) në zonat e banuara. Fushatë informuese	Mbuluar nga pagat e personelit.	Buxheti i Bashkisë
		FL-3	Njoftimi i aktiviteteve me zhurmë (servise, gomisteri, bare, furra buke etJ) të licensuara në Tiranë urbane (zonë prioritare sipas njësive mësipër) për oraret e punës lidhur me zhurmat, Ndalimet dhe penaltetet për shkeljet si dhe detyrimin për kontrollin e zhurmës dhe pajisjeve zhurmuese. Informimi aktiv i subjekteve që janë në listen e gjenerimit të zhurmave (shpërmdaresit e picave të marrin masa për motorcikletat zhurmëse, riparime etj)	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		FL-4	Rishikimi i licensave të dhëna për shfrytëzim objekti në Qytetin e Tiranës (njesitë e qytetit) për aktivitetet me zhurmë dhe reflektimi i kushteve të nevojshme për kontrollin e zhurmës.	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		FL-5	Kontrolle në mjedise të brendshme për nivelin e zhurmës dhe mbrojtjen e shëndetit publik nga keto zhurma (veçanërisht baret që përdorin muzikë në nivele tej normave të lejuara për zhurmat në mjedise të mbyllura).	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
4	Ndergjegjesim sensibilizim për zhurmat (NS)	NS-1	Afishimi i tabelave informuese, sensibilizuese për nivelin e shpejtësisë, ndalimin e borive në zonat prioritare, përfshirë dhe penaltetet përkatëse.	Buxheti i Bashkisë	Buxheti i Bashkisë
		NS-2	Fushata ndërgjegjesimi dhe informimi mbi ndotjen akustike Promovimi i masave për kontrollin e zhurmave në faqen elektronike të Bashkisë dhe në rrjetet sociale të Bashkisë	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë

Nr	Objektivi prioritar		Masat prioritare	Kosto në LEK	Burimi i financimit
		NS-3	Fushate sensibilizuese në media (RTSH etj) dhe terren për kufizimin e zhurmave	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		NS-4	Vendosja e nje njoftimit nga administratorët në këndin e njoftimeve për rregullat për zhurmat në restaurimet e brendshme, ankesat etj.	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		NS-5	Edukimi dhe fushata ndërgjegjesimi për reduktimin e zhurmës.	Buxheti i Bashkisë	Buxheti i Bashkisë
5	Raportimi, publikimi dhe bashkëpunimi me OSHC dhe grupet e interesit (RP)	RP-1	Publikimi i informacionit grafik për nivelet e zhurmave në qytet (hartë dhe grafike) faqen elektronike të Bashkisë Tiranë	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		RP-2	Forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimi me shoqërinë civile dhe qytetarët për zbatimin e planit të veprimit të zhurmave	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë
		RP-3	Raportimi mbi ecurinë e zbatimit të planit	Mbuluar nga pagat e personelit	Buxheti i Bashkisë

Kosto totale të njohura për zbatimin e masave të rekomanduara për periudhën 5 vjeçare përfshijnë: 70,000,000 Leke (prokurime mallrash, shërbime konsulence, trajnime, mirëmbajtje dhe kalibrim pajisjesh, fushate ndërgjegjesimi dhe edukimi, printime, etj) Zbatimi i Planit të Zhurmave është parashikuar të kërkojë një fond prej 30,000,000 Leke vitin e parë për shkak të blerjes së pajisjeve, kalibrimit të tyre, trajnimeve, vendosja e mjeteve sinjalizuese (tabela), fushate intensive ndërgjegjesimi dhe edukimi, si dhe procesi i hartimit dhe evidentimit të zonave problematike. Pjesa tjetër e buxhetit prej 40,000,000 Leke është parashikuar të shpërndahet për periudhën 4 vjeçare, në varësi të zerave që do të mbulojnë çdo vit, sipas Planit të Veprimit të Zhurmave. Më saktësisht, kosto e ndarë në vite është:

- Viti i parë i zbatimit 2023, me kosto totale prej 30,000,000 ALL
- Viti i dytë i zbatimit 2024, me kosto totale prej 10,000,000 ALL
- Viti i tretë i zbatimit 2025, me kosto totale prej 10,000,000 ALL

- Viti i katërt i zbatimit 2026, me kosto totale prej 10,000,000 ALL
- Viti i pestë i zbatimit 2027, me kosto totale prej 10,000,000 ALL

Në këtë buxhet nuk llogariten kostot e pagave të personelit aktual me rol në zbatimin e masave si dhe kosto e investimit në izolimin akustik në objektet sociale në administrim të Bashkisë Tiranë. Plotësimet e nevojshme me sinjalistike për kufizimet e shpejtesisë dhe zhurmës në objektet të vecanta sociale (spitale) është bërë një parashikim paraprak, por jo përfundimtar. Këto kosto nuk njihen aktualisht do të përcaktohen rast pas rasti nga personeli përgjegjës i Bashkisë.